



Ludwig Boltzmann Institute
of Human Rights

Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë – Gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal

Botues

Instituti për të drejtat njerëzore “Lludvig Bolltman” – BIM-FV, Shkup
Përgatitja dhe shtypi i këtij botimi financiarisht janë përkrahur nga
Bashkëpunimi austriak për zhvillimi (ADC)

Përgatitje

Svetllana Trbojeviq, Instituti për punë sociale dhe politikë sociale

Projekt

Të drejtat njerëzore dhe përfshirja sociale në Maqedoni
Instituti për të drejtat njerëzore “Lludvig Bolltman” – BIM-FV, Shkup
rr. „Velko Vllahoviq“ nr. 1 A-1/4 1000 Shkup
tel.: +389 (0)2 3216 956
faks: +389 (0)2 3216 982

Skudra për përkrahje nga BIM-FV, Shkup

Petranka Dellova Milladinova – projekt menaxher
Stojan Mishev – këshilltar për të drejtat njerëzore
Ninoslav Mlladeniviq – këshilltar për të drejtat njerëzore
Jagoda Iljov – asistent administrativ

Person për përkrahje nga Ministria për punë dhe politikë sociale e RM

Irena Todoroska – Udhëheqëse e Sektorit për përfshirje sociale

Përkthim

Mirije Sulmati

Qëndrimet e paraqitura këtu, si dhe ato të autorëve jo gjithmonë e paraqesin pozitën zyrtare të Institutit për të drejtat njerëzore “Lludvig Bolltman” (BIM-FV) dhe të Bashkëpunimit austriak për zhvillim (ADC)

Përmbajtje

Parathënie	5
Fjalim përshëndetës i zëvendës ministrit për punë dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë, Z. Ibrahim Ibrahimi	6
Fjalim përshëndetës i Znj. Petranka Dellova-Milladinova, udhëheqëse e BIM-FV Shkup	8
Fjalim përshëndetës nga Znj. Milla Carovska, kryetare e Platformës maqedonase kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale (PMKV)	10
HYRJE	14
Sfida me të cilat ballafaqohen aktorët kryesor në sistemin e mbrojtjes sociale gjatë procesit të decentralizimit	16
Identifikimi i mungesave gjatë veprimit të institucioneve në nivel lokal	22
Problemet dhe nevojat e identifikuara sociale të grupeve të varfëra dhe të prekshme të popullatës në bashkësi dhe kapacitetet e komunave për tejkalimin e tyre	25
Transmetimi i praktikave pozitive	27
Përfitime nga zbatimi i Parimit të bazuar mbi të drejtat njerëzore në proceset e përgatitjes së Strategjive lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në tetë komuna	30
Përfitime nga përfshirja aktive e grupeve të varfëra dhe të prekshme në sjelljen e vendimeve në nivel lokal	32
Hapa të ardhshëm në procesin e decentralizimit të mbrojtjes sociale	35
Konkludime dhe rekomandime	38
Listë e personave prezent në tryezën e rrumbullakët – Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë të organizuar më datë 30.03.2012	43
Literatura e shfrytëzuar	45

Parathënie

Në tre vitet e fundit, Instituti për të drejtat njerëzore “Lludvig Boltzman”, përmes një sërë aktiviteteve në mënyrë të drejtëpërdrejtë i përkrahu përpjekjet e Ministrisë për punë dhe politikë sociale në zbatimin e procesit të decentralizimit të mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë. Në këtë proces, instituti i është përkushtuar promovimit të Qasjes së bazuar mbi të drejtat njerëzore (QBDNJ). Në pajtim me përpjekjet të cilat janë ndërmarrë në nivel kombëtar, në veçanti në nivel lokal, përcaktimi kryesor i institutit është që të sigurojë përkrahje për procesin e decentralizimit të mbrojtjes sociale në vend. Për këtë qëllim më datë 30.03.2012, në bashkëpunim me MPPS u organizua Tryezë e rumbullakët me titull “Decentralizimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale në Republikën e Maqedonisë – Gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal”.

Rezultat i këtij evenimenti është ky botim, i cili në veti i përmban çështjet eseniale të cilat ishin temë diskutimi e përfaqësuesve të pushtetit qendror, njësitëve të vetëqeverisjes lokale, sektorit qytetar dhe organizatave ndërkombëtare. Rezultatet kryesore të studimeve të BIM-FV të cilat paraqisnin bazë për tërë procesin, gjegjësisht të dhënat për vendosjen institucionale të sistemit të mbrojtjes, ose më saktësisht gjendjes faktike të grupeve të varfëra dhe të prekshme, si dhe rreziqet ekzistuese në këtë fushë janë gjithashtu pjesë përbërëse e këtij botimi. Prezantimet, gjegjësisht fjalimet hyrëse të Z. Ibrahim Ibrahim, zëvendës ministër i MPPS, Znj. Petranka Dellova Milladinova, projekt menaxher i BIM-FV Shkup dhe Znj. Milla Carovska, kryetare e PMKV janë të inkorporuara në fillimin e këtij botimi, si hyrje në pjesën e cila pason.

Fjalim përshëndetës i zëvendës ministrit për punë dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë, Z. Ibrahim Ibrahimi

Të nderuar prezent,

Nëse kohezioni do të thotë rruga drejtë idealit, përfshirja sociale është mjet për të prekur deri te mirëqenia të cilët duhet ta ketë çdo qytetar i këtij shteti. Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria për punë dhe politikë sociale bindshëm dhe me energji e shkelin këtë rrugë, duke ndërmarrë aktivitete për uljen e varfërisë dhe ç'kyçjes sociale.

Sigurimi i kushteve më të mira për jetesë të qytetarëve është imperativ për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë për punë dhe politikë sociale, por gjithashtu edhe për komunat. Mu me decentralizimin e mbrojtjes sociale së bashku krijojmë kushte për një shoqëri inkluzive dhe kohezive.

Varfëria dhe ç'kyçja sociale e grupeve të prekshme nuk është e panjohur dhe ne nuk i injorojmë këto probleme, në fakt punojmë në mënyrë aktive për të gjetur zgjidhje.

Nga kjo edhe Qeveria e RM e miratoi Strategjinë kombëtare për ulje të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale 2010-2012, e cila e portretton qëllimin e Republikës së Maqedonisë për ta barazuar shkallën e përfshirjes dhe mirëqenien e të gjitha shtresave në shoqëri.

Qëllimi kryesor strategjik për uljen e varfërisë dhe ç'kyçjes në Republikën e Maqedonisë është:

Ulja e varfërisë dhe ç'kyçjes sociale në Republikën e Maqedonisë përmes shfrytëzimit më të mirë të resurseve të disponueshme njerëzore dhe materiale, përmirësimin e kushteve jetësore, për punë dhe të kushteve shoqërore të të gjithë qytetarëve, bashkëveprimi sistemik dhe institucional në funksion të zhvillimit më të shpejt, standardit më të lartë dhe jetesës më kualitative.

Më lejoni që në këtë rast të theksoj se veç programeve ekzistuese për ndihmë në para, këtë vit Qeveria miratoi programe të posaçme me të cilat sigurohet ndihmë shtesë për familjet më të rrezikuara dhe atë: Program për mbrojtje sociale, Program për ulje të varfërisë energjetike për subvencionimin e shpenzimit të energjisë dhe Program për kompenzim kushtëzues në para për ndjekjen e rregullt

të shkollës së mesme për fëmijët nga familjet shfrytëzuese të NSP, përmes të cilit programi jemi të mendimit se do të ndikojmë në transmetimin transgjenerator të varfërisë.

Për ndërtimin e një shoqërie kohezive, në të cilën lufta kundër varfërisë dhe ç'kryes sociale do të thotë ekzistimi i "shanseve dhe mundësive të barabarta për të gjithë" pa kusht, është i nevojshëm veprimi i përbashkët i të gjithëve... kur them të gjithë, mendoj në ministritë, vetëqeverisjen lokale, Platformën maqedonase kundër varfërisë dhe ç'kryes sociale, organizatat joqeveritare, por edhe çdo individ.

Padyshim, parimet e participimit, koordinimit dhe transparencës duhet të jenë parakushtet bazike në ndërtimin e strategjive lokale, si dhe për ndërlidhshmërinë e tyre me politikën nacionale.

Me ndihmën e Agjencisë austriake për zhvillim dhe Institutit për të drejtat njerëzore Ludvig Boltzman e hapëm procesin në tetë (8) komuna në vend dhe atë në: Likovë, Studeniçan, Pehçevë, Berovë, Negotinë, Radovish, Konçe dhe Çashka. Aktorët më relevant në nivel lokal u bashkuan dhe krijuan strategji lokale për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale në bazë të nevojave reale të detektuar të grupeve të marginalizuara. Në moment rrjedhin mikro-projektet, përmes të cilave financiarisht i përkrahëm organizatat joqeveritare të cilat i mbrojnë interesat e grupeve të prekshme në nivel lokal.

Decentralizimi i mbrojtjes sociale ofron mundësi dhe sfida të panumërta për një rol më aktiv të komunave në përmirësimin e kualitetit të jetesës së qytetarëve të tyre, ndërsa në veçanti të atyre më të prekshmeve. Dhe jo vetëm të komunave, por edhe të sektorit joqeveritar.

Në fund, më lejoni që edhe njëherë ta theksoj rëndësinë e veprimit të përbashkët, për shkak se ndërmarrja e aksioneve konkrete në masë të madhe do të kontribuojë për parandalimin, ndihmimin dhe mbrojtjen e familjeve socialisht të rrezikuara.

Definitivisht ka hapsirë për përmirësimin e gjendjeve dhe jam i bindur se së bashku do të krijojmë "shanse dhe mundësi të barabarta për të gjithë" të cilat do të jenë të pakushtëzuara.

Fjalim përshëndetës i Znj. Petranka Dellova-Milladinova, udhëheqëse e BIM-FV Shkup

I nderuari Z. Zëvendës ministër Ibrahim,

Të nderuar kryetarë të komunave.

Partnerë të projektit, mysafirë...

Në emër të Institutit për të drejtat njerëzore “Ludvig Boltzman”, më lejoni t’u dëshiroj mirëseardhje në diskutimin e sotshëm në temën Decentralizimi i mbrojtjes sociale në nivel lokal, gjegjësisht sfidat me të cilat ballafaqohen komunat në sigurimin e kushteve sociale për shfrytëzuesit e tyre.

Diskusionin e organizuam në suazat e projektit Përfshirja sociale dhe të drejtat njerëzore në Maqedoni, të cilin e zbaton BIM-FV Shkup. Bëhet fjalë për projekt tre vjeç, i financuar nga ana e Agjencisë austriake për zhvillim, në suazat e të cilit bashkëpunojmë me një numër të madh të OJQ-ve, anëtare të Platformës maqedonase kundër varfërisë dhe tetë komuna (Likovë, Studeniçan, Çashka, Negotinë, Radovish, Konçe, Berovë dhe Pehçevë), përfaqësuesit e të cilave janë edhe sot prezent.

Bashkëpunimi në nivel lokal përfshinte proces të krijimit të strategjive lokale për përfshirje sociale, mbrojtje sociale dhe ulje të varfërisë, si dhe zbatimin e pilot projekteve të orientuara kah sferat prioritare të strategjive të çdo komune. Bëmë disa analiza dhe studime për përcaktimin e gjendjes të kategorive më të prekshme të qytetarëve dhe organizuam një sërë trajnimesh për përforcimin e kapaciteteve lokale në sferën e të drejtave njerëzore, përfshirjes sociale dhe uljen e varfërisë.

Gjatë punëtorive dhe takimeve të shumta të cilat i kishëm me përfaqësues të ndryshëm të komunave tuaja, shpesh herë u ballafaquam me pikëpamje të ndryshme për gjendjen e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale në nivel lokal. Nga njëra anë, kishëm shfrytëzues të shërbimeve sociale të cilët pak a shumë janë të pakënaqur nga ajo që ndodh në këtë sferë në nivel lokal, ndërsa nga ana tjetër, ndëgjuam pretekste ose arsyttime për të njejtën nga të punësuarit në komunë, më saktësisht për atë se mbrojtja sociale dhe çështjet sociale ende nuk janë të decentralizuara.

Mu kjo na nxiti që ta organizojmë diskutimin e sotshëm, në të cilin presim që të ndëgjohet qëndrimi i të gjithë aktorëve në këtë sferë, ndërsa para së gjithash që të kuptojmë deri ku ka arritur procesi i decentralizimit të mbrojtjes sociale dhe cilat janë hapat e mëtutjeshme të cilat do të ndërmerren për përmirësimin e jetesës së shfrytëzuesve.

Presim një diskutim të frytshëm i cili do të rezultojë me rekomandime për përmirësimin e gjendjeve në nivel lokal...



Fjalim përshëndetës nga Znj. Milla Carovska, kryetare e Platformës maqedonase kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale (PMKV)

I nderuari Zëvendës ministër Ibrahim,
I nderuari Kryetar komune Z. Llazarev,
Të nderuar përfaqësues të vetëqeverisjeve lokale,
përfaqësues të shoqatave qytetare...

Siqë më prezantuan, unë jam kryetare e Platformës maqedonase kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, e krijuar në vitin 2010, me qëllim që ta bashkojë sektorin joqeveritar në luftën kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, mirëpo gjithashtu edhe me qëllim që ta paraqesë interesin e qytetarëve në krijimin e të gjitha politikave kombëtare dhe lokale. Mbi 40 organizata më janë anëtare të Platformës maqedonase, ndërsa dhjetë të tjera janë kandidatë për anëtarësim për kuvendin e ardhshëm. Kjo na tregon se bashkimi me të vërtetë mund të kontribuojë në rritjen e zërit dhe ndëgjueshmërisë të sektorit joqeveritar në përfaqësimin përpara institucioneve shtetërore.

Dua të përmend disa nga aktivitetet të cilat janë zbatuar në periudhën prej gati dy viteve, nga viti 2010 e deri tani. Normal se do t'i përmendim vetëm ato të cilat janë më të rëndësishme, për shkak se nëse i përmendim të gjitha kjo do të na marrë shumë kohë. Në vitin 2010 përmes Platformës maqedonase, me përkrahje të Agjencisë austriake për zhvillim përmes Institutit për të drejtat njerëzore Ludwig Boltzman, u bë një fushatë që Maqedonia t'i bashkangjitet Fushatës evropaine për luftë kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale. Në fakt, jam e bindur se të gjithë e dini fushtën "Çdo i treti maqedonas bën një jetë të varfër". Kishëm edhe reagime pozitive, edhe reagime negative lidhur me këtë fushtë. Disa thoshin se kjo është e vërtetë, por edhe se nuk është e vërtetë. Ne deshëm që të inicojmë debat i cili do të tregojë se jo çdo i treti bën një jetë të varfër, por çdo i pari nëse flasim për kualitetin e jetesës dhe jo për kushtet minimale për jetesë të cilat në Maqedoni në njëfar mënyre janë të matshme. Gjithashtu, gjëja e ardhshme e cila u bë në vitin 2011 është konferenca e parë për persona të varfër dhe të ç'kyçur e cila u organizua në Manastirë dhe në të cilën ishin prezent mbi 120 grupe të prekshme. Të njëjtit persona përgatitën deklaratë të personave të varfër dhe të ç'kyçur, të cilën i'a dorë-

zuan ministrit Spiro Ristovski, i cili pranoi pesë nga grupet socialist të ç'kyçura dhe të prekshme dhe i ndëgjoi kërkesat e tyre. Ai normal se dha përgjigje politike për atë se do t'i shqyrtojë kërkesat e tyre, mirëpo do të shohim se çfarë do të ndodhë në ardhmëri dhe si do të veprojnë lidhur me të njejtat. Gjithashtu u zbatua edhe një marsh i të varfërve dhe të ç'kyçurve, dhe u përgatit raport për personat e varfër dhe të ç'kyçur për vitin 2010.

Platforma maqedonase është anëtare e Platformës evropiane kundër varfërisë, e cila me të vërtetë jep një mundësi të madhe për të ndikuar si mbi politikën kombëtare ashtu edhe në ato evropiane, si dhe për portretimin e politikave evropiane në nivel kombëtar. Platforma maqedonase kundër varfërisë do të vazhdojë ta ndjekë krijimin e politikave kombëtare dhe lokale, mirëpo gjithashtu jo vetëm krijimin por edhe zbatimin e të njejtave, dhe me këtë rast do t'i ndjekë edhe buxhetet dhe shpenzimin e tyre. Jemi të mendimit se kjo është shumë e rëndësishme, për shkak se realokimi i mjeteve të parapara për mbrojtje sociale ndodh që shpesh të jetë i keqpërdorur, ndërsa besoj se të gjithë shoqatat e qytetarëve, mjetet të cilat janë paraparë për mbrojtje sociale, kanë interes që të mbesin në buxhetin kombëtar për këtë qëllim.

Cili është qëndrimi i sektorit joqeveritar lidhur me rolin e të njejtit sa i takon decentralizimit ose lidhur me mbrojtjen sociale? Parimisht, sektori joqeveritar në moment ka mundësi, në pajtim me ligjin, që të jetë pjesë e ofrimit të shërbimeve sociale. Mirëpo praktika të tilla pozitive thuajse nuk kemi në terren. Përse? Për shkak të asaj se nuk janë miratuar mekanizma për atë se si disa organizata të caktuara do të bashkangjiten, në cilën mënyrë ato do të paguhen. Për shkak të asaj se e njehta nuk mund të realizohet përmes skemës së granteve. Këtu duhet të bëhet fjalë për vlerësimin e kualitetit, duhet të bëhet fjalë për pagesën për shërbimin të cilin do ta ofrojë sektori joqeveritar, duhet të bëhet fjalë për thyerjen e monopolit të mbrojtjes sociale të cilin tani e ofron shteti. Ndërsa për t'u bërë kjo është i nevojshëm një rrjet i tërësishëm i institucioneve joqeveritare, shtetërore dhe faktorëve të tjerë në vend, të cilët duhet ta zhvillojnë tërë këtë sistem, jo vetëm të decentralizimit por edhe të shpërndarjes së mbrojtjes sociale me rolin e serviseve sociale ndaj partnerëve të tjerë social në vend. Nëse e njehta mund të bëhet praktikë e mirë në nivel kombëtar, besoj se do të mund të ulet edhe në nivel lokal. Në moment me një pjesë

të njërive të vetëqeverisjes lokale me të cilat sektori joqeveritar bashkëpunon, kanë kapacitete ose kanë shfaqur interes për të ndërmarrë një pjesë të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, mirëpo një pjesë e tyre nuk kanë kapacitete për ta bërë të njëjtin. Jam e mendimit se kjo do jetë pjesë e diskutimit të sotshëm, gjegjësisht për atë se sa njësitë e vetëqeverisjes lokale mund ta ndërmarrin mbrojtjen sociale. Si sektor joqeveritar, jemi të mendimit se decentralizimi do ta përmirësoj kualitetin. Gjëja e parë përmes të cilës do ta përmirësojmë kualitetin është ajo se vlerësimi i nevojave të qytetarëve do të bëhet nga një grup më i vogël i kryetarëve të komuneve ose skuadrave për mbrojtje sociale, mbrojtje feminare dhe shëndetësore, të cilët do të bëjnë vlerësime në terren me një numër më të vogël të banorëve dhe aktivitetet ose veprimet në mënyrë të drejtëpërdrejtë do t'i orientojnë kah target grupet specifike në nivel lokal. Këto nuk do t'i krijojmë në nivel kombëtar dhe t'i aplikojmë të njëjtat ose po t'i modifikojmë edhe në nivel lokal.

Gjithashtu, diçka të cilën dua ta theksoj sa i takon mbrojtjes sociale është ajo se Maqedonia duhet t'i kushtoj kujdes Strategjisë së re për përfshirje aktive e cila kërkon që të gjitha shtetet të cilat synojnë t'i bashkangjiten Bashkimit Evropian që ta zbatojnë këtë strategji. Kjo do të thotë se Maqedonia duhet të miratojë ndihmë minimale sociale, një çështje të cilën ende nuk e kemi hapur për shkak se ne ende flasim për një rroge minimale të denjshme, e cila është një nga komponentat e strategjisë për përfshirje aktive. Komponenta e dytë është kualiteti i serviseve të cilat duhet t'i ofrojmë në nivel kombëtar dhe lokal, dhe e treta është ndihma minimale sociale. Unë këtë dua ta hap vetëm si pyetje, dhe më tej duhet të hapim tribuna dhe diskutime të reja mu për këtë strategji dhe këto aksione të cilat Evropa i kërkon nga Republika e Maqedonisë. Unë dua t'i hap këto çështje dhe nëse keni pyetje shtesë jam e hapur për të njëjtat.

Listë e shkurtesave

BIM-FV	Instituti për të drejtat njerëzore Lludivig Bolltman
BE	Bashkimi Evropian
BNJVL	Bashkësia e njësisve të vetëqeverisjes lokale
IPA	Instrumenti i ndihmës së para aderimit
GPL	Grupet partnere lokale
PMKV	Platforma maqedonase kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale
MPPS	Ministria për punë dhe politikë sociale
OJQ	Organizata joqeveritare
OGP	Organizata e grave Pehçevë
QBDNJ	Qasja e bazuar mbi të drejtat njerëzore
RM	Republika e Maqedonisë
QRPPPI	Qendra republike për përkrahjen e personave me pengesa intelektuale
UNDP	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për fëmijët i Kombeve të Bashkuara

HYRJE

Instituti për të drejtat njerëzore Ludvig Boltzman vitet e fundit në mënyrë aktive punon në promovimin e Qasjes së bazuar mbi të drejtat njerëzore (QBDNJ), në përpjekjet të cilat shteti jonë i ndërmerr në drejtim të uljes së varfërisë dhe ç'kyçjes sociale. Në fakt, qëllimi kryesor i projektit Të drejtat njerëzore dhe përfshirja sociale në Maqedoni është zbatimi i QBDNJ në proceset e miratimit të vendimeve në nivel kombëtar dhe lokal. Pjesë përbërëse e përkrahjes të cilën Instituti e jep në këtë drejtim është përforcimi i kapaciteteve të institucioneve relevante, organeve dhe organizatave, të cilat si bartëse të detyrave duhet të marrin rol aktiv në realizimin e të drejtave të grupeve të varfëra dhe të prekshme të popullatës. Paralelisht punohet në përforcimin e kapaciteteve të bartësve të të drejtave, duke pasur parasysh se përfshirja e tyre është e domosdoshme dhe esenciale për realizimin e ndryshimeve të dëshiruara në shoqërinë tonë, dhe përmirësimin e gjendjeve ekzistuese në sferën e të drejtave njerëzore, mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale. Në nivel kombëtar, BIM-FV në mënyrë aktive e përkrah Platformën maqedonase kundër varfërisë (PMKV)¹ në përpjekjet e saj për afirmimin dhe promovimin e politikave të BE-së, si dhe politikave të RM-ës, të orientuara kundër varfërisë, ç'kyçjes sociale dhe diskriminimit.

Në nivel lokal, në bashkëpunim me MPPS dhe 8 komuna² u përkrah përgatitja dhe miratimi i Strategjive lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë 2011-2015. Bazë për përgatitjen e dokumenteve strategjike ishte gjendja e përcaktuar faktike në studimet për gjendjet me varfërinë dhe ç'kyçjen sociale. Qëllimet specifike të projektit në nivel lokal janë:

- ✓ T'i përfshijë të dhënat paraprakisht të grumbulluara në Studimin për varfëri dhe ç'kyçje sociale në RM në procesin e përpilimit të dokumenteve strat-

1 PMKV paraqet union të rreth 39 organizatave qytetare, të pavarura, jopartiake, shoqata joformale të qytetarëve, grupe për vetëndihmë, sindikata dhe individë të cilët punojnë në fusha të ndryshme, dhe të cilët i bashkuan përpjekjet e tyre për t'i theksuar problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët dhe janë të interesit të tyre të përbashkët, ndërsa janë të orientuara në promovimin e barazisë dhe drejtësisë sociale, demokracisë participative dhe solidaritetit qytetarë, si dhe me qëllim që të sigurojnë përgjegjësi dhe llogaridhënie të institucioneve publike dhe organeve shtetërore kompetente lidhur me respektimin e obligimeve dhe detyrave ndërkombëtare të ndërmarra. Kontributin e tyre kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale e japin përmes prizmes së realizimit të të drejtave njerëzore të grupeve të ndryshme të prekshme të cilat i përfaqësojnë.

2 Negotinë, Likovë, Berovë, Pehçevë, Studeniçan, Çashka, Radovish dhe Konçe.

- egjike për varfëri, mbrojtje sociale dhe ç'kyçje sociale në secilën prej komune të përzgjedhura partnere;
- ✓ T'i përkrahë Grupet partnere lokale (GPL) në procesin e identifikimit të grupeve të prekshme sociale të cilat janë më të marginalizuara dhe ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë;
 - ✓ T'i përkrahë GPL në përpjekjet për përcaktimin e problemeve prioritare të personave të prekshëm dhe të varfër dhe gjetjen e zgjidhjeve për integrimin e tyre;
 - ✓ Ta promovojë modelin e pjesëmarrjes participative në procesin e planifikimit të zhvillimit lokal;
 - ✓ Ta përfshijë aspektin gjinor në tërë procesin e planifikimit strategjik dhe veprues, në veçanti duke e pasur parasyshë varfërinë femrore dhe ç'kyçjen sociale të grave, si dhe relacionet e fuqisë gjatë sjelljes së vendimeve në nivel lokal;
 - ✓ Ta përfshijë aspektin e mbrojtjes së mjedisit jetësor në tërë procesin e planifikimit strategjik dhe veprues.

Përfshirja në këtë iniciativë u mundësoi Njësive të vetëqeverisjes lokale që të fillojnë me përmirësimin e gjendjeve në sferën e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale në nivel lokal. U arrit nivel më i madh i vetëdijes për gjendjen me grupet e varfëra dhe të prekshme në bashkësi. Zbatimi i QBDNJ do të thotë të merren parasyshë nevojat dhe problemet lokale të popullatës, përcaktimi i prioriteteve në pajtim me gjendjen faktike dhe zbatimi i masave dhe aktiviteteve konkrete në drejtim të përmirësimit të mungesave të evidentuara. Nga kjo pritet që praktikrat pozitive nga kjo iniciativë, të cilat ishën temë e diskutimit në vetë tryezën e rrumbullakët, të paraqesin bazë për përsëritjen e një procesi të tillë gjithëpërfshirës dhe të koordinuar në komunat tjera në Republikën.

Sfida me të cilat ballafaqohen aktorët kryesor në sistemin e mbrojtjes sociale gjatë procesit të decentralizimit

Pas pavarësimit në vitin 1991, Republika e Maqedonisë përjetoi shkallë të lartë të decentralizimit e cila ndikoi mbi zhvillimin lokal dhe e imponoi nevojën për fillim të paanulueshëm të procesit të decentralizimit. Ky proces, më saktësisht, decentralizimi fiskal në Republikën e Maqedonisë filloi gjatë vitit 2004 me miratimin e Ligjit për financimin e Njërive të vetëqeverisjes lokale, mirëpo zbatimi i të njejtit filloi më 01.07.2005.

Pas vitit 2004, komunave i'u dha mundësia dhe përgjegjësia që t'i zhvillojnë funksionet sociale në nivel lokal, gjegjësisht të krijojnë programe për përmbushjen e nevojave të grupeve në rrezik social. Ligji parashihte mundësi që komunat të zhvillojnë forma jashtinstitucionale të mbrojtjes, përmes krijimit dhe organizimit të qendrave për strehim ditor dhe të përkohshëm të qytetarëve, në varësi të nevojave të tyre, si dhe të organizojnë dhe zbatojnë mbrojtje sociale për qytetarët e territorit të tyre përmes miratimit të programeve të tyre zhvillimore, në pajtim me nevojat specifike. Me Ligjin për mbrojtje sociale të vitit 2009 u fut elementi detyrues, sipas të cilit komuna ka përgjegjësi që programet zhvillimore t'i bëjë në pajtim me programet strategjike të Ministrisë për punë dhe politikë sociale. "Intenca kryesore e procesit të decentralizimit në sferën e mbrojtjes sociale ishte që komunat të fitojnë ndjenjën e pronësisë në rolin e zgjidhjes së problemeve sociale për grupet e prekshme në territorin e tyre. Gjegjësisht, intencat kryesore të ndryshimeve të rregullativave ligjore janë të orientuara kah përfshirja aktive e komunave në procesin e decentralizimit... Mirëpo nuk duhet të pritët që decentralizimi i sistemit të mbrojtjes sociale të jetë i suksesshëm vetëm kur atëherë kur transferohen kompetencat e institucioneve prej në nivel qendror në atë lokal. Kështu që në vend nga Ministria për punë dhe politikë sociale, drejtori i njërit prej institucioneve do të jetë i emruar nga kryetari i komunës. Kjo nuk është decentralizim." (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale, MPPS).

Zbatimi i procesit të decentralizimit komunave u imponoi sfida të cilat para së gjithash dalin nga mospërputhshmëria e madhësisë së komunës dhe spektrit të kompetencave dhe kapacitetet financiare, kadrovike dhe të tjera për planifikimin

dhe zbatimin e kompetencave³, si dhe dallimet e mëdha nga aspekti i zhvillimit mes pjesës urbane dhe rurale në kornizat e një komune.

Në përpjekje për t'u identifikuar potencialet e njësive të vetëqeverisjes lokale për zbatimin e decentralizimit në sferën sociale nga ana e Institutit për të drejtat njerëzore – Llundvig Bolltman, në kornizat e projektit “Përfshirja sociale dhe të drejtat njerëzore në Maqedoni” u zbatuan dy hulumtime veçmas⁴. Këto hulumtime kishën për qëllim që t'i vlerësojnë gjendjet dhe t'i identifikojnë sfidat me të cilat ballafaqohen aktorët kryesor në sistemin e mbrojtjes sociale gjatë procesit të decentralizimit. Gjatë kësaj u përcaktua se problemi kryesor me të cilin komunat ballafaqohen del nga rrjeti jo mjaft i zhvilluar dhe i papërshtatshëm i institucioneve⁵. Është konstatuar se rrjeti ekzistues i institucioneve për mbrojtje institucionale dhe jashtinstitucionale nuk mund në mënyrë adekuate t'u përgjigjet nevojave të identifikuar të qytetarëve. Për grupet primare të prekshme të popullatës siqë janë fëmijët dhe personat e moshuar, nuk ka numër të mjaftueshëm të çerdheve fëmimore dhe shtëpive për pleq, gjegjësisht kapacitetet ekzistuese nuk i përmbushin nevojat e popullatës lokale.

Sipas kryetarit të komunës së Konçes “çerdhet fëmimore në komunar rurale

3 Kompetencat e komunave u përcaktuan me Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 2002. Kështu që sipas ligjit komunat përpos përgjegjësisë për planifikimin urban, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, zhvillimit ekonomik, punëve komunale, arsimit, kulturës, sportit dhe rekreimit, fitojnë edhe përgjegjësi në sferën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes fëmimore (çerdhet fëmimore) dhe shtëpitë për të moshuarit – pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje, realizimin e kujdesit social për personat me invaliditet dhe për fëmijët pa prindër, fëmijët me nevoja të posaçme dhe kompetenca të tjera në sferën sociale të cilat janë të përcaktuara brenda ligjit. Përpos kompetencave të cekura burimore, ligji parasheh edhe delegimin e kompetencave, ku organet shtetërore mund në pajtim me ligjin t'ia delegojnë zbatimin e punëve të caktuara kryetarit të komunës.

4 „Analiza e gjendjeve aktuale në mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale, e zbatuar në gjashtë komuna (Shtip, Prilep, Kërçovë, Saraj, Çashka dhe Radovish)” dhe „Studimi për varfëri dhe ç'kyçje sociale në RM i zbatuar në tetë komuna (Radovish, Konçe, Çashka, Negotinë, Pehçevë, Berovë, Likovë dhe Studençan).

5 Edhe pse temë e këtij botimi nuk janë gjendjet nd mbrojtjen institucionale në sferën e mbrojtjes shëndetësore, jemi të mendimit se duhet të theksohen dhe konstatohen edhe gjendjet në këtë sferë. Gjegjësisht, si edhe në aspekt të mbrojtjes sociale edhe në sferën e mbrojtjes shëndetësore është konstatuar se ekziston shpërndarje jo e barabartë e shërbimeve në komunat urbane kundrejt vendbanimeve rurale në kufinj të komunave. Rrjeti i institucioneve shëndetësore në komunat urbane është kënaqës, ndërsa në komunat rurale është dobët i zhvilluar. Në numrin më të madh të komunave rurale nuk ka barnatore, ordianca specialistike, shërbim për ndihmë të shpejtë, ndërsa ambulancat ekzistuese nuk janë të qasëshme për qytetarët natën dhe gjatë fundjavës. Më e vështirë është qasja e qytetarëve nga vendbanimet malore rurale në institucionet shëndetësore. “Probleme të posaçme paraqiten në pjesën e kulturës. Atje ku paraprakisht kanë ekzistuar qendra kulturore shteti kujdeset për ta, ndërsa atje ku nuk ka ekzistion njëfar selektiviteti” (Llazrev, kryetar i komunës së Konçes).

janë krejtësisht të lëna pas dore, gjegjësisht ka një selektivitet të krijuar shumë kohë më parë. Mirëpo me decentralizimin ky problem do të thellohet dhe atje ku nuk ka çerdhe feminare, gjegjësisht fëmijët në komunat rurale nuk kanë mundësi për t'u vendosur".

Banorët e komunave rurale kanë qasje të vështirësuar deri tek qendrat për punë sociale për shkak se nuk ka njësi lokale të qendrave kompetente, ndërsa qasje më të kufizuar deri tek qendrat kanë banorët e vendbanimeve malore. Gjithashtu, në asnjërën prej komunave nuk janë evidentuar investime në infrastrukturën e sferës së mbrojtjes sociale.

Sa u takon kapaciteteve kadrovike në komunat e hulumtuara, është përcaktuar se në një pjesë të madhe prej tyre ka ekipim joadekuat të njërive për punë publike, kundrejt nevojave nga sfera e mbrojtjes shëndetësore, sociale, feminare dhe mbrojtjes së grupeve të tjera të prekshme. Gjithashtu, nuk ka person të punësuar i cili do të jetë përgjegjës për çështjet nga sfera e mbrojtjes sociale. Mirëpo, mbi kapacitetet për dhënien e shërbimeve për qytetarët ndikon edhe fenomeni i zhvendosjes, një proces me të cilin në veçanti janë kapluar komunat më të vogla, ndërsa i njëjti e rrezikon procesin e decentralizimit.

Nxitja e bashkëpunimit multisektoral është një nga parakushtet e domosdoshme përmes të cilit mund të intenzivohet procesi i decentralizimit. Mirëpo, hulumtimet tregojnë se në pjesën më të madhe të komunave mungon qasja multi-sektorale lidhur me parandalimin social mes aktorëve relevant, komunave, qendrave për punë sociale, institucioneve parashkollore, shkollore dhe shëndetësore, dhe organeve të ndryshme shtetërore, personave juridik dhe fizik, si dhe shoqatave të qytetarëve. Bashkëpunimi mes komunave, Qendrën për punë sociale dhe sektorit qytetarë vlerësohet për të qenë joadekuat. Edhe pse ekziston një numër i madh i shoqatave qytetare të regjistruara, brengos fakti se aktive janë vetëm një numër i vogël i tyre. Më së shpeshti sektori qytetarë participon në miratimin e planeve vepruese dhe dorëzimin e projekteve, mirëpo jo mjaft merr pjesë në participimin gjatë monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve.

Sipas përfaqësuesit të Zyrës kombëtare të Qendrës republikane për përkrahjen e personave me pengesa intelektuale (QRPPPI) Poraka, Z. Krstevski, kapacitetet nuk varen nga implikimet financiare por nga vetë aktorët, gjegjësisht nga përfaqësuesit

e organizatave joqeveritare dhe nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale. Nga vetë organizatat joqeveritare varet se sa arrijnë që t'i imponojnë kërkesat e tyre, ndërsa nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale varet se sa të përkushtuar do të jenë së bashku me organizatat joqeveritare dhe sa do të insistojnë që të zgjedhin ndonjë nga çështjet ose nevojat e sektorit joqeveritar. "Mirëpo, në procesin e marrjes së mjeteve nga pushteti lokal ka një problem. Gjegjesisht, në një thirrje të komunës për mjete financiare paraqiten të gjitha organizatat nga të gjitha sferat; shoqata sportive, shoqata të bletarëve, shoqata të ekologjistëve dhe shoqatat të personave me nevoja të posaçme, personave të moshuar etj. Në këtë proces duhet të bëhet një distinkcion i vogël e ajo është jo se nënçmohen bletarët ose ekologjistët, mirëpo organizata e cila punon në sferën e mbrojtjes sociale ose të drejtat njerëzore duhet të perceptohet në mënyrë të ndryshme, në veçanti nëse ajo organizatë paraqitet si sigures i një servisi konkret social. Për shkak se në një thirrje të komunës prej 500,000 denarë, aplikojnë 50 organizata dhe me të vërtetë paraqet problem nëse mes tyre ka organizatë e cila organizon punën në një qendër ditore dhe shpenzimet e të cilës janë 2 deri më 3 milion denarë. Në një situatë të tillë përkrahja e cila pritet, që në fillim është e qartë se nuk mund të fitohet. Këtu është pengesa e madhe mes asaj që është legjislative, e betuar institucionalisht dhe ajo e cila realisht mund të realizohet. Ligji për mbrojtje sociale komunave u jep kompetenca, mirëpo ligji thotë se ato munden por se nuk janë të detyruara, dhe nuk i ofron mekanizmat e nevojshëm se si kjo do të jetë në mënyrë të vërtetë e realizueshme në nivel lokal (Krstevski, zyra kombëtare e QRPPPI, Poraka).

Përfaqësuesi nga Shoqata qytetare e personave me paralizë celebrale nga Çashka e theksoi participimin e pamjaftueshëm financiar të komunave për aktivitete projektive të sektorit joqeveritar me çfarë do të sigurohet qëndrueshmëria e tyre. "Shumë shpesh përkrahja është deklarative, shumë pak nga buxhetet e komunave dedikohen për aktivitetet e organizatave joqeveritare. Ato mbijetojnë me donacionet nga jashtë, mirëpo është e nevojshme që kjo të identifikohet edhe nga pushtetet lokale. Nëse dikush nga jashtë ka dhënë mjete që të gjallërohet ndonjë aktivitet në nivel lokal, me të vërtetë është e nevojshme që vetë pushteti lokal ta vërejë këtë dhe në ardhmëri ta financojë të njëjtën. Aktorët e huaj kërkojnë qëndrueshmëri. Edhe pse organizatat joqeveritare në projekt propozimet e tyre thek-

sojnë se pushteti lokal do t'u ndihmojë, do të përfshihet, e njejtja ose asnjëhere nuk ndodh ose shumë rrallë ndodh. Nëse duam që të kemi edhe decentralizim të vetëmbrojtjes sociale duhet shumë të punohet në rrjetëzimin, në respektin mes institucioneve, organizatave joqeveritare dhe pushtetit lokal, për shkak se të gjitha këto ekzistojnë për qytetarët të cilët jetojnë në ato komuna, mirëpo për t'u arritur rezultate konkrete duhet të punohet në mënyrë të organizuar dhe së bashku (Zlataeva, kryetar i Shoqatës së personave me paralizë celebrale, Çashka).

Për përfaqësuesin e komunës së Pehçevës bashkëpunimi multisektoral është më tepër përjashtim se sa rregull. Kjo do të thotë se orientimi i pushtetit lokal ndaj institucioneve të pushtetit qendror është më i suksesshëm. Realizohen programe të përbashkëta dhe të njejtat janë çdo vit më të mira, mirëpo nuk mund t'i iket faktit se ky bashkëpunim nuk është në nivel çdoditor. Për shembull, kur realizohet një program i përbashkët për punë të dobishme komunale ose program për masat aktive për punësim atëherë bashkëpunimi është më kualitativ, më i mirë, që do të thotë se duhet të punohet edhe në programe të tjera të cilat do ta nxisin këtë bashkëpunim. Mirëpo në rastin konkret, komuna e Pehçevës është në një pozitë specifike e cila buron nga ajo se i ndan shërbimet e përbashkëta me komunën e Berovës. Kjo disaherë sjell situata të pafavorshme në veçanti kur nuk ka burim zyrtar të informatave. Për shembull marrim informata nga burime të tjera për punë të cilat implementohen nga ana e Agjencisë për punësim ose nga Ministria, punë të cilat ndodhin në territorin e komunës së Pehçevës, në veçanti në sferën e mbrojtjes sociale.

Mes përfaqësuesve të sektorit qytetarë theksohet se bashkëpunimi multisektoral është i prishur për shkak të jokompatibilitetit lidhur me kapacitetet me të cilat disponojnë pushtetet lokale kundrejt kapaciteteve në sektorin joqeveritar. Gjegjësisht "ka pengesë mes sektorit joqeveritar dhe pushtetit lokal. Nga njëra anë sektori joqeveritar përforcohet dhe edukohet, ndërsa nga ana tjetër pushteti lokal funksionon vetëm me komisione ose me një anëtarë i cili punon në sferën e mbrojtjes sociale ose anëtarë të komisioneve të cilën duhet të sjellin vendime dhe ndoshta nuk kanë kurrëfar dijenie nga sfera e mbrojtjes sociale dhe del se bashkëpunimi mes sektorit joqeveritar dhe pushtetit lokal ende është në fillim... Gjithashtu, decentralizimi nuk do të mund të arrihet pa përfshirjen e më tepër faktorëve si në niv-

el të pushtetit lokal ashtu edhe në nivel kombëtar. Ka plane vepruese lokale të miratuara, të zbatuara nga ana e sektorit joqeveritar, mirëpo kur duhet që konkretisht të jepen financa atëherë komunat tërhiqen dhe thonë se kanë shumë pak mjete për të cilat konkurojnë më tepër organizata. Nuk duhet të lejohet që planet vepruese të zbatohen vetëm nga sektori joqeveritar, ndërsa në zbatimin e tyre është paraparë që të përfshihen të gjithë” (Trajkovska, kryetar i Qendrës republike për përkrahje të personave me hendikep mental “Poraka” Negotinë).

Një nga sfidat kryesore me të cilat komunat ballafaqohen është edhe nevoja për bashkëpunim proaktiv të komunës me biznes sektorin. Gjegjësisht, tërheqja e interesit të biznes komunitetit jo vetëm me qëllim që të investojë në sferën sociale, por edhe me qëllim të përfshirjes më aktive në sferën e administrimit të ndihmës dhe përkrahjes së aktiviteteve në këtë fushë. Komunat duhet të inkurajojnë iniciativa për grumbullimin e mjeteve për përmirësimin e kushteve jetësore të grupeve të varfëra dhe të prekshme.

Sfidë e posaçme për komunat është konkurimi për marrjen e granteve për çështjet nga afëra e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale nga fondet evropiane dhe institucionet e tjera financiare ndërkombëtare.

Identifikimi i mungesave gjatë veprimit të institucioneve në nivel lokal

Disa nga mungesat më të mëdha të cilat janë identifikuar gjatë veprimit të institucioneve në nivel lokal janë të ndërlidhura me mekanizmat institucionale relativisht dobët të zhvilluara; mekanizmat për identifikimin dhe përfshirjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme; senzitivitetin për nevojën për planifikim strategjik në sferën e mbrojtjes sociale; kapacitetet për zbatimin e masave më të gjëra për ndihmë dhe përkrahje për kategoritë e prekshme të popullatës; senzitivitetin e kuadrit profesional, si dhe senzitivitetin e personave profesional për punë me grupe të prekshme.

- Mekanizma institucional për mbrojtje sociale dobët të zhvilluara
Në një pjesë të komunave të anketuara kur janë zbatuar hulumtimet janë evidencuar probleme të cilat burojnë nga numri jo i mjaftueshëm i kuadrove përgjegjëse për çështjet nga sfera e mbrojtjes sociale ose ekipimi joadekuat në njësitë për punë publike në komunat, kundrejt nevojave nga sfera e mbrojtjes sociale, shëndetësore, fëmimore dhe mbrojtja e grupeve të prekshme. Më saktësisht, janë identifikuar funksione të mbrojtjes sociale dobët të zhvilluara, mungesë e njësive të posaçme për mbrojtje sociale dhe mungesë e punonjësve social të punësuar.

- Mosekzistimi i mekanizmave për identifikimin dhe përfshirjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Është verifikuar mungesë lidhur me një mekanizëm formalisht të etabluar dhe të standardizuar për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Në komunat më së shpeshti ka mungesë të bazës së të dhënave për çështje të ndërlidhura me mbrojtjen sociale, të krijuar sipas grupit synues, kriteret për fituesit e ndihmës dhe të ngjajshme, ndërsa për problemet e grupeve të prekshme më së shpeshti kuptohet përmes dorëzimit të kërkesave nga ana e qytetarëve ose përmes bashkësive urbane/lokale.

- Mungesë e senzitivitetit për nevojën për planifikim strategjik në sferën e mbrojtjes sociale

Në periudhën kur janë zbatuar hulumtimet nuk është identifikuar planifikim strategjik në sferën e mbrojtjes sociale, mirëpo pas hulumtimeve të zbatuara në

të gjitha tetë komunat partnere janë krijuar Strategji lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë, si dhe plane vepruese. Sipas Znj. Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtjes sociale në MPPS, në fillim një numër i vogël i komunave u janë përgjigjur thirrjeve me shkrim të ministrisë që të bëhen pjesë e procesit të krijimit të strategjive dhe planeve vepruese, ndërsa sot edhe pse bëhet fjalë për detyrë ligjore, në procesin e krijimit të planeve vepruese ende të gjithë komunat nuk janë aktive. Sipas saj, “strategjitë dhe planet vepruese lokale nuk duhet të kuptohen si dokumente të cilat duhet proforma të miratohen me qëllim që të përmbushen kërkesat e ligjit. Është e kundërta, gjegjësisht pritet komunat të sensibilizohen dhe t’i identifikojnë nevojat e qytetarëve të tyre, ta përcaktojnë vullnerabilitetin, t’i identifikojnë mundësitë për atë se si dhe në cilën mënyrë më së lehti t’ua sigurojnë shërbimet sociale qytetarëve të tyre në vendbanimin e tyre. Ky është definicioni thelbësor i decentralizimit të pushtetit lokal. Ministria në këtë proces është e gatshme dhe në mënyrë transparente t’u ndihmojë komunave, të bashkëpunojë, të kontaktojë, t’i orientojë, t’u ndihmojë që planet vepruese mos jenë vetëm përpjekje deklarative, por së pari të çojnë në rrjetëzimin e të gjithë bartësve në nivel lokal dhe kah ndërmarrja e masave konkrete sociale.”

- Kapacitete dobët të zhvilluara për zbatimin e masave më të gjëra për ndihmë dhe përkrahje të kategorive të prekshme të popullatës

Ekziston tendenca e krijimit të programeve për mbrojtje sociale dhe planeve strategjike për punësim. Programet për mbrojtje sociale në përgjithësi janë të fokusuara në ndihmën financiare dhe nuk i përmbushin kriteret bazike metodike dhe metodologjike. Më së shpeshti mjetet të cilat ndahen janë në formë të ndihmës së njëhershme në para. Në buxhetet e komunave nuk ka paragraf të posaçëm për mbrojtje sociale, ndërsa mjetet të cilat ndahen për mbrojtje sociale janë minimale ose mesatarisht janë nën 1% nga buxheti. Njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk kanë zhvilluar forma për mbrojtje sociale për grupet e prekshme të popullatës. „Kapacitetet e pushtetit lokal për zbatimin e procesit të decentralizimit të mbrojtjes sociale janë të mjaftueshme në sferën e transfereve në para, gjegjësisht në aspektet joprofesionale të kësaj fushe dhe jemi të mendimit se aspektet profesionale duhet për një periudhë më të gjatë të mbesin në tërësi në sferën e qendrave për punë sociale. Pushteti lokal ndihmon në pjesën e ndihmës materiale dhe këtë e bënë në mënyrë

joformale dhe formale, mirëpo pa kurrëfar mjete të posaçme” (Llazarev, kryetar i komunës së Konçes). Mirëpo, sipas ndihmës udhëheqësit të Sektorit për mbrojtje sociale, Spasovska, „kompenzimet në para nuk janë çelsi kryesor i decentralizimit. Kompenzimet në para paraqesin krijimin e politikës në nivel kombëtar dhe kanë për qëllim që t’i përmbushin nevojat kryesore jetësore të qytetarëve. Niveli i tyre është shumë i ulët, mirëpo kjo varet nga shumë kritere, varet nga konteksti dhe mundësitë e një shteti të caktuar, nga programet të cilat si shtesë merren për aktivizimin e shfrytëzuesve dhe në vend që të jenë shfrytëzues pasiv të ndihmës sociale, të përfshihen në sistemet tjera dhe të bëhen të barabartë dhe të njejtë me qytetarët tjerë. Një nga pritjet e ministrisë është se komunat ngadalë do të fillojnë t’i zhvillojnë kapacitetet, do të përfshihen dhe do t’i zhvillojnë shërbimet sociale në nivel lokal.” Mirëpo, nga hulumtimet mund të konstatohet se për këtë kategori të qytetarëve nuk ka masa dhe aktivitete sistematike të cilat janë të përshtatur me nevojat e tyre. Shumë më rrallë komunat zbatojnë masa aktive për tejkalimin e këtyre problemeve. Komunat nuk kanë aktivitete të vazhdueshme për angazhimin e punëtorëve të aftë për punë për zbatimin e punëve të interesit publik. Kjo masë ka të bëjë me mjetet financiare nga Ministria për punë dhe politikë sociale dhe nuk është e vazhdueshme, dhe nga kjo në vitin 2010 punë publike gati se aspak nuk realizohen. Në disa komuna, kjo masa u përjetua si degraduese sepse realizimi i saj llogaritet se ndikon negativisht mbi popullaritetin e pushteteve lokale.

- Mungesa sistematike për shfrytëzimin e të drejtave nga mbrojtja sociale
Ekzistojnë mungesa sistematike të cilat i pamundësojnë grupet e varfëra dhe të prekshme sa i takon shfrytëzimit të të drejtave të caktuara. Një pjesë e kategorive të prekshme të qytetarëve nuk i shfrytëzon të drejtat nga mbrojtja sociale për shkak të painformimit, mospërmbushjes së kushteve, rrefuzimit dhe turpfit.
- Josenzitiviteti i personave profesional për punë me grupet e prekshme
Në pajtim me vendosshmërinë aktuale të sistemit të mbrojtjes sociale, qendrat për punë sociale janë përgjegjëse për zbulimin dhe administrimin e ndihmës dhe përkrahjes së drejtëpërdrejtë të kategorive të prekshme të qytetarëve në nivel lokal. Mirëpo, në bazë të hulumtimeve të bëra është konstatuar se ato ballafaqohen me mungesë të kuadrit profesional dhe personelit teknik, si dhe probleme të ndërlydhura me mungesën e paisjeve adekuate teknike, veturave terrenike, paisjeve

kompjuterike, gjëra këto të cilat pamundësojnë sigurimin profesional dhe adekuat të ndihmës. Gjithashtu, në to nuk ka të siguruara kushte për pritje dhe punë adekuate me klientët, ndërsa mungojnë edhe punonjës social të detashuar të cilët do ta zbatojnë funksionin e njësisë së shpërndarë të qendrave në mjediset rurale. Mirëpo, këto mungesa të konstatuara ndërlidhen edhe me mungesën e kapaciteteve dhe shkathtësive të personave profesional për punë me grupet e prekshme. Prandaj është e nevojshme që theksi të vendoset mbi zhvillimin e programeve për edukim të personave profesional, që ato më mirë ta ndjnjë pulsën e popullatës me të cilën punojnë. Edukimet do t'i përforcojnë shkathtësitë dhe teknikat e tyre për punë dhe mobilizim të popullatës dhe në këtë mënyrë do të rritet bashkëpunimi i popullatës me institucionet.

Problemet dhe nevojat e identifikuara sociale të grupeve të varfëra dhe të prekshme të popullatës në bashkësi dhe kapacitetet e komunave për tejkalimin e tyre

Varfëria dhe papunësia⁶ janë problemet më të theksuara sociale në të gjitha komunat dhe shkalla e tyre më së shpeshti e portretin mesataren kombëtare. Në komunat rurale varfëria nga aspekti i sigurimit të nevojave ekzistenciale është më pak e theksuar në krahasim me komunat urbane. Nga kjo, komunat si dhe qendrat për punë sociale parimisht janë të koncentruara në përmbushjen e kërkesave në para të kategorive të qytetarëve të cilët janë socialisht të rrezikuar dhe të pasiguruar materialisht.

Si rezultat i prezencës afatgjate të varfërisë dhe papunësisë, në komunat është evidentuar edhe rritje e problemeve të ndërlidhura me disfunksionet dhe devijimet familjare. Veçohet rritja e alkoolizmit, narkomanisë, dhunës familjare, delikuencës së mitur, si dhe në një numër më të vogël të komunave rritje e problemit me martesat e mitura. Përpos personave të varfër dhe të papunësuar, si kategori më të përgjithshme të prekshme në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku janë zbatuar

6 Papunësia është shumë më e shpeshtë tek popullata femrore dhe personat me kualifikime të ulta, të cilët presin punësim tetë dhe më tepër vite. Struktura moshore e të papunësuarve është e pafavorshme për shkak të pjesëmarrjes së madhe të popullatës së re në moshë 15-24 vjeç, si dhe të fuqisë punëtore më të moshuar mesjetare. Popullata rritet ka shkallë të lartë të pjesëmarrjes në kategorinë e personave të papunësuar.

hulumtimet janë identifikuar edhe personat e moshuar, personat me invaliditet, si dhe shfrytëzuesit e ndihmës së përhershme në para. Shpesh, në kategoritë e të prekshmeve socialisht në një pjesë të komunave mund të gjenden edhe përfaqësues të bashkësive të caktuara etnike siqë janë përfaqësuesit e bashkësisë etnike turke dhe rome. Jo mjaft ose aspak nuk janë të identifikuar nevojat e grupeve vulnerable të veçanta, siqë janë shfrytëzuesit e drogës.

Në komunat mungon numër i mjaftueshëm i iniciativave në aspekt të sigurimit të shërbimeve sociale për grupet e prekshme dhe të marginalizuara, në veçanti për banorët e vendeve rurale brenda komunës së tyre. Mungesa e iniciativës, në veçanti duke pasur parasyshë faktin se “jo të gjithë shërbimet sociale janë të shtrenjta, të pamundshme për t’u realizuar dhe varen nga novacioni i komunave, përpjekja e tyre dhe përfshirja e të gjithëve në nivel lokal” (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS).

Painformimi, siqë është theksuar edhe paraprakisht, paraqet një problem të përgjithshëm i cili i pengon njerëzit që t’i realizojnë të drejtat e tyre, në veçanti sa i takon realizimit të të drejtës së ndihmës sociale në para. Me qëllim që të rritet shkalla e informimit për të drejtat në sferën e mbrojtjes sociale, Instituti për të drejtat njerëzore – Ludvig Boltzman, përmes organizatave qytetare partnere siguroi përkrahje shtesë për zbatimin e aktiviteteve të karakterit informativo-edukativ. Aktivitetet e përkrahura në këtë mënyrë janë pjesë përbërëse e strategjive lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë.

Është i përgjithshëm qëndrimi se mjetet të cilat ndahen përmes qendrave për punë sociale për popullatën e aftë për punë dhe materialisht të pasiguar, përmes ndihmës sociale në para, nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të bartësve dhe familjeve të tyre. Qytetarët materialisht të pasiguar nga viti 2010 nuk mund ta realizojnë të drejtën e ndihmës së njehershme në para, e drejtë të cilën më së shpeshti e shfrytëzonin për kompenzim dhe shpenzimeve për mbrojtje shëndetësore. Kuzhinat popullore dhe subvencionet për energji elektrike realizohen si aktivitete përmes projekteve. Edhe pse në numrin më të madh të komunave ekzistojnë kuzhina popullore, të njejtat kanë kapacitete të kufizuara dhe nuk mund t’i shërbejnë të gjithë të cilët kanë nevojë që t’i shfrytëzojnë shërbimet e tyre.

Transmetimi i praktikave pozitive

Para së gjithash, duhet të theksohet interesi i komunave për përfshirjen në procesin e udhëhequr nga BIM-FV. Gjegjesisht, komunat shprehën shkaqet e lartë të gatishmërisë jo vetëm për pjesëmarrje në hulumtimet dhe edukimet e zbatuara, por edhe me vetëdije e pranuan sfidën që të ndajnë mjetet e tyre për realizimin e planeve të miratuara për veprim. Kjo paraqet një hap pozitiv, gjegjesisht ndërmarrjen e rolit proaktiv në sferën e përmirësimit të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale në nivel lokal, gjë e cila paraqet një lloj të përkrahjes edhe ndaj procesit të ardhshëm të decentralizimit në sferën e mbrojtjes sociale.

Praktikat pozitive në fushën e decentralizimit të orientuara kah tejkalimi i gjendjeve të konstatuara në hulumtimet e lartpërmendura për gjendjet lokale, do të prezantohen në nivel lokal, në nivel të sektorit joqeveritar duke përfshirë edhe aktivitetet të cilat janë ndërmarrë në bashkëpunim me këto dy sektorë.

- Aktivitete të cilat zbatohen nga njësitë e vetëqeverisjes lokale

Konkretisht komuna e Konçes e cila ka një buxhet modest dhe të vogël, mirëpo çdo vit parasheh një pjesë të vogël të mjeteve të drejtëpërdrejta për ndihma sociale. Më saktësisht, vitin e kaluar janë planifikuar 200.000 denarë, ndërsa janë shpenzuar 209.000 denarë për ndihmë të drejtëpërdrejtë. Që do të thotë se në mënyrë të drejtëpërdrejtë me vendim të Këshillit u janë transferuar para qytetarëve. Transferi është bërë ose me kërkesë ose me baza të ndryshme. Shpesh trajtohen raste të kërkesave për shkak të varfërisë dhe më së shpeshti ato janë kërkesa për mjekime, mirëpo ka edhe metoda tjera me të cilat ndihmohet. Komuna ka krijuar një aktivitetet të rregullt i cili ndërmerret gjatë vitit të ri, në kornizat e të cilit bëhet shqyrtim i nevojave të personave në gjithë komunën dhe jepet një shumë e caktuar e parave ose mjeteve në naturë, gjegjesisht pakove sociale. Komuna është në mënyrë të drejtëpërdrejtë e kyçur në projektin kuzhinë popullore. Kjo ndoshta është një detyrë e vështirë, mirëpo distribuimi bëhet në të gjitha vendbanimet edhe përpos të largësisë së vendbanimeve dhe arrin që t'i shërbejë të gjithë të cilët më së shumti kanë nevojë nga kjo. Ushqimi merret nga Radovishi, gjegjesisht nga çerdhja feminare ku edhe ai përgatitet.

Në mënyrë të pavarur, për një muaj u organizua edhe projekt për punë publike. Qëllimi ishte që t'u ndihmohet njerzive, por edhe të përmirësohet mjedisi. Ky projekt nuk është shumë i shtrenjtë, kushton diku rreth 100.000 denarë. Këtë vit përsëri organizohet projekt për punë publike. Gjithashtu, në suazat e mundësive ndërmerret edhe një numër i madh i aktiviteteve tjera.

Përmes projektit të UNICEF-it u mbuluan shpenzimet, mirëpo me qëllim që të vazhdohet me projektin është miratuar vendim nga ana e komunës së Konçes që të ndahen 160.000 denarë për shpenzimet e sigurimit të një edukatori.

Në komunën e Pehçevës në vazhdimësi zbatohen punë publike, ndërsa funksionon edhe projekti për kuzhina popullore.

- Aktivitete të zbatuara nga sektori qytetarë

Poraka nga Negotina është organizatë joqeveritare të cilës Ministria për punë dhe politikë sociale i ka deleguar kompetencë që ta zbatojë procesin e deinstitutionalizimit. Deinstitutionalizimi i personave me pengesa në zhvillim realizohet në tre vitet e fundit dhe strehon 63 persona, të cilët tani jetojnë në shtëpi individuale si çdo qytetarë tjetër. Qendra për përkrahjen e personave me hendikep mental "Poraka" Negotinë, punëson 40 persona, që do të thotë se 40 familje jetojnë nga dhënia e shërbimeve. Organizata është më shumë e njohur jashtë kufinjve se sa në vetë komunën. Të gjitha informatat janë në disponim të komunës dhe të kryetarit të komunës dhe të këshilltarëve, mirëpo diçka mungon dhe ajo është edukimi me të cilin do të përmirësohet bashkëpunimi mes sektorit joqeveritar dhe pushtetit lokal, mirëpo edhe me biznes sektorin. Poraka Negotino ka bashkëpunim të mirë dhe përkrahje nga Ministria dhe organizatat siqë janë Instituti për të drejtat njerëzore Llundvig Bolltman, të cilat i përkrahin dhe i përshpejtojnë proceset e deinstitutionalizimit dhe decentralizimit, të cilat inicojnë transferimin e ingerencave në sektorit joqeveritar (Trajkovska, kryetar i organizatës qytetare "Poraka" nga Negotina).

- Aktivitete të cilat janë ndërmarrë mes njësive të vetëqeverisjes lokale dhe sektorit joqeveritar

Shembuj pozitiv janë ato të organizatave Poraka nga Kumanova dhe Poraka Struga, ku në kërkesë të zyrës kombëtare, thënë kushtimisht është bërë presion mbi

pushtetin lokal dhe është bërë marrëveshje për kryerjen e punëve të interesit publik me rëndësi lokale. Kjo kontratë është bërë sipas nenit 24 nga Ligji për vetëqeverisje lokale, i cili parasheh partneritet të drejtëpërdrejtë mes organizatave joqeveritare dhe pushtetit lokal. Me këtë nen dhe mekanizëm u arrit që në këto dy komuna të sigurohet financimi komplet i një qendre ditore për persona me kufizime. E njejtja bëhet edhe në Shkup, ku qyteti i Shkupit mbulon 70% të shpenzimeve për qendrën ditore, ndërsa në qytetin e Ohrit zyrat janë të komunës dhe e njejtja krejtësisht i renovon ato. Poraka me përkrahje të Ministrisë dhe të Institutit Ljudvig Bolltman, mirëpo gjithashtu me përkrahje të madhe të komunës së Radovishit, nga buxheti i saj jo aq i madh ndau një milion denarë. Reçeta për partneritet të vërtetë dhe një reçetë e cila mund të ketë sukses është vetëm nëse palet e bëjnë atë me dëshirë, me imponimin e nevojës dhe nëse janë zemër hapur. Nuk konkludojmë por japim udhëzime për atë se si duhet të mendohet. Kapacitetet varen nga vetë ne dhe nga vetë ju, nga të gjithë të cilët janë të përfshirë në këtë punë. Decentralizimi në pajtim me prefiksën de, do të thotë humbje e fuqisë së pushtetit qendror, mirëpo kjo fuqi juve ju transferohet në aspekt financiar dhe kjo është një çështje tjetër për të cilën duhet të bisedohet në një nivel tjetër. (Krstevski, zyra kombëtare e QRPPPI Poraka).

Si shembull pozitiv i bashkëpunimit multisektoral do të theksohet edhe bashkëpunimi i cili për disa vite zhvillohet mes komunës së Pehçevës, Ministrisë dhe Fondit edukativ rom lidhur me arsimin parashkollor të fëmijëve rom. Komuna me këto dy partnerë realizon edhe projekt për ndërtimin e çerdhes fëminore në vendbanimin Crnik. Gjithashtu, në Pehçevë ka edhe bashkëpunim aktiv mes komunës dhe organizatës së grave nga Pehçeva. Ky bashkëpunim para së gjithash është i inkurajuar përmes përkrahjes të cilën Instituti për të drejtat njerëzore i'a dha organizatës joqeveritare. Kjo organizatë ka pasur përkrahje edhe në të kaluarën nga komuna, mirëpo më tepër nga aspekti logjistik se sa nga ai financiar. Edhe pse organizata një kohë më të gjatë mbijeton në territorin e komunës së Pehçevës, ajo megjithatë nuk është mjaft aktive në shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti. Më së shpeshti kërkesat e tyre dorëzohen pasiqë buxhetet e komunës të miratohen. Ndihejma e fituar praktike nuk është paraparë në buxhet, por është e veçuar në paragrafe tjera buxhetore, nga të cilat mund të jepen vetëm mjete minimale.

Përfitime nga zbatimi i Parimit të bazuar mbi të drejtat njerëzore në proceset e përgatitjes së Strategjive lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në tetë komuna

Siqë e theksuam në fillim, Instituti për të drejtat njerëzore – Llundvig Bolltman zbatoi dy hulumtime të cilat u bënë për nevojat e përgatitjes së strategjive dhe programeve vepruese aplikative dhe të zbatueshme, si dhe zbatimin e pilot projekteve në sferat prioritare të identifikuar nga ana e komunave. E rëndësishme është që të theksohet se në këto hulumtime është zbatuar qasja e bazuar mbi të drejtat njerëzore në fushën e uljes së varfërisë dhe ç'kryes sociale në nivel kombëtar dhe lokal, gjë e cila përfshin identifikimin e grupeve të prekshme, përfshirjen e tyre të drejtëpërdrejtë në proceset e miratimit të vendimeve të cilat do të ndikojnë mbi jetën e tyre, si dhe krijimin e një sistemi për mbikqyrje dhe llogaridhënie të bartësve të detyrave.

Të gjitha tetë komunat u përfshinë në mënyrë aktive në përgatitjen e strategjive lokale për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë. Mirëpo, në këtë pjesë më konkretisht do të fokusohemi në elaborimin e zbatimit të parimit të bazuar mbi të drejtat njerëzore në procesin e përgatitjes së strategjive lokale për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Konçes. Ajo është një nga komunat e para e cila e miratoi strategjinë dhe është në proces të zbatimit të planit veprues dhe realizimit të një pjese të masave. Kundrejt vetëdëshmërisë dhe senzibilitetit për rëndësinë e këtyre çështjeve për zhvillimin e komunës së Konçes, ky është dokumenti i parë strategjik nga sfera e mbrojtjes sociale. Paraprakisht, Komisioni për punë komunale i formuar brenda Këshillit të komunës së Konçes çdo vit krijonte program për punë publike në të cilin ishte edhe pjesa për mbrojtje sociale. Programi kishte të bëjë me të dhënat materiale, më saktësisht ndihmën e njëhershme. Në vitin 2011, Ministria për punë dhe politikë sociale bëri vlerësim të programit komunal të vitit 2010. U evidentua se komuna në vend që të sygjerohë masa aktive, më së shpeshti qytetarëve socialisht të rrezikuar u jep kompenzime në para. Komunës i'u sygjerua që të punojë në gjetjen e më tepër masave dhe formave përmes të cilave qytetarët socialisht të rrezikuar do të angazhohen

dhe do të përfshihen në programet dhe projektet e ndryshme.

Programi i ri i komunës është krijuar në pajtim me esencën e mbrojtjes moderne sociale. Programit i prin një analizë detale e gjendjes së komunës lidhur me atë se çfarë do të thotë përfshirja sociale dhe varfëria. Studimi mundëson një njohuri për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve të cilëve mund t'u ndihmohet përmes masave sistemike. Programi veprues vendos theks më të madh mbi realizimin e një pjesë të masave të parapara në strategjinë. Disa nga masat në strategjinë janë drejtëpërdrejtë të përfshira në program dhe të njejtat pritet që përmes aktiviteteve praktike të zbatohen këtë vit. Duke e pasur parasysh gjendjen lokale, nuk bëhet fjalë për shumë aktivitete dhe pritet që me përpjekje maksimale lokale të njejtat të realizohen. Besohet se njohja sistemike e problemeve dhe nevojave sociale të qytetarëve do të sjellë deri tek tejkalimi i suksesshëm i më tepër gjendjeve sociale. E rëndësishme është të theksohet se mjetet financiare për aktivitetet janë të miratuara nga Këshilli, mirëpo llogaritet se të njejtat nuk do të jenë të mjaftueshme. Pritet që mjete shtesë për realizimin e aktiviteteve të fitohen nga Ministria, donacione dhe fonde të jashtme. Strategjia lokale parasheh edhe vlerësimin e aktiviteteve të cilat do të zbatohen në periudhën prej vitit 2012 deri më vitin 2015. Pritet që strategjia të kontribuojë për përmirësimin e gjendjeve sociale në komunën e Konçes.

Gjithashtu, mendojmë se është e rëndësishme që të theksohet nevoja e qëndrueshmërisë së aktiviteteve të parapara në strategjitë lokale dhe nevoja për një pjesëmarrje participative në to. Znj. Pljakova, bashkëpuntor për zhvillim ekonomik lokal nga komuna e Çashkës, thekson se komunat kanë eksperiencë në përgatitjen e planeve strategjike, mirëpo se të njejtat ballafaqohen me vështirësi në zbatimin e tyre. Në një aspekt të caktuar, garancioni për suksesin e strategjive konkrete del nga përkrahja të cilën njësitë e vetëqeverisjes lokale e marrin nga Instituti për të drejtat njerëzore, Llundvig Bolltman, i cili ndihmoi jo vetëm në krijimin e strategjisë në nivel lokal në të gjithë tetë komunat, por edhe ndihmoi në sigurimin e mjeteve për realizimin e asaj që është paraparë. Bashkimi i mjeteve dhe resurseve paraqet garancion për zbatimin e aktiviteteve të parapara ose më konkretisht zbatimin e tetë mikro projekteve. Mirëpo, vështirësitë do të pasojnë më tej për shkak se është e nevojshme që të sigurohet qëndrueshmëri e projekteve, ndërsa për arritjen e

qëndrueshmërisë duhet të krijohet bashkëpunim me BNJVL. Gjithashtu, duhet të bëhet rrjetëzim i të gjithë palëve pavarësisht nëse ato janë institucione në nivel kombëtar, në nivel lokal, sektori qytetarë, komunat, bashkësitë lokale, biznes sektori ose individë. Vepruesit e drejtëpërdrejtë duhet të krijojnë një bashkëpunim më të afërt, të punojnë në zhvillimin e shkathtësive të reja⁷ për identifikim e nevojave në nivel lokal, t'i prekin nevojat e qytetarëve dhe në këtë mënyrë të ndikojnë mbi rritjen e beneficionit lokal.

Sipas Z. Todorovska, udhëheqës i Sektorit për përfshirje sociale në MPPS, grupeve partnere lokale u mungon ndjenja e pronësisë për strategjitë lokale. “Më saktësisht, kjo ndjenjë mungon edhe tek komunat edhe tek sektori joqeveritar, por edhe tek biznes sektori. Strategjitë lokale janë të bashkësisë lokale, të të gjithë vepruesve relevant të cilët punojnë në nivel lokal për përmirësimin e shërbimeve sociale. Edhe pse mbisundon qëndrimi se Instituti e bëri strategjinë, mendojmë se secili duhet vetë ta gjejë veten në zbatimin praktik të saj. Në këto tetë pilot komuna është arrit rezultat në drejtim të përforcimit të kapaciteteve të tyre. Instituti për të drejtat njerëzore – Llundvig Bolltman ndihmoi që grupet partnere lokale të përfshihen dhe të ndërtojnë orientimin dhe politikën e tyre me qëllim që të përmirësohet përmbushja e të drejtave të qytetarëve në nivel lokal.”

Përfitime nga përfshirja aktive e grupeve të varfëra dhe të prekshme në sjelljen e vendimeve në nivel lokal

Me qëllim që të përpilohen plane vepruese më adekuate dhe më precize është i nevojshëm bashkëpunimi në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin në nivel kombëtar, regional dhe lokal. Përpos bashkëpunimit me institucionet ekzistuese dhe me sektorin joqeveritar në nivel lokal, komunat kanë nevojë dhe detyrë që në mënyrë aktive dhe me më shumë guxim t'i përfshijnë grupet e varfëra dhe të prekshme në procesin e identifikimit të nevojave të tyre. Me qëllim që të maksimizohen përfitimet nga zbatimi i procesit të bazuar mbi të drejtat njerëzore, është i nevojshëm participimi aktiv i bartësve të të drejtave. Përfshirja e

7 Çështja për zhvillimin e shkathtësive për punë me popullatën lokale është e theksuar në pjesën e rekomandimeve dhe konkludimeve dhe është elaboruar nga profesoresha Maria Donevska nga Instituti për punë sociale dhe politikë sociale.

kategorive të prekshme të qytetarëve duhet të zhvillohet në të gjitha fazat e procesit, duke e përfshirë këtu edhe analizimin e nevojave, definimin e problemeve prioritare, planifikimin e programeve, si dhe zbatimin e aktiviteteve konkrete për tejkalimin e të njejtave. Vetëm përmes një qasje të tillë gjithëpërfshirëse, komunat mundën me më shumë përgjegjësi t'i qasen planifikimin të pakove të shërbimeve sociale dhe të njejtat t'i programojnë dhe orientojnë kah grupet e prekshme të caktuara. Në këtë kontekst do të përmendet edhe shembulli i komunës së Pehçevës, ku gjatë zbatimit të procesit të planifikimit strategjik dhe veprues për përcaktimin e prioriteteve të komunës u formuan fokus grupe me qëllim që të kontrollohet se a janë aktivitetet e planifikuara në pajtim me nevojat reale të qytetarëve. Përmes pjesëmarrjes participative, prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme propozuan përgatitjen e materialeve informative për të drejtat të cilat u pasojnë. Propozimi është inkorporuar në strategjinë ekzistuese lokale.

Gjithashtu, komuna e Pehçevës është partner në financimin e projektit i cili përfshin më tepër sektorë. Do të thotë se projekti multisektoral ka të bëjë me skuadrën mobile për vizitë, kujdes dhe trajtimin e personave të sëmurë dhe të moshuar në kushte shtëpiake. Në fakt, vetë realizimi i projektit nënkupton përmeshjen e një pjese të nevojave të dy grupeve të prekshme të qytetarëve. Gjegjësisht, nga njëra anë projekti i targeton personat e moshuar dhe të paafte, ndërsa nga ana tjetër ndihmon në uljen e numrit të grave të papunësuara për një kohë më të gjatë nga komuna e Pehçevës. Do të thotë se është bërë përpjekje për identifikimin dhe përfshirjen e personave të moshuar, ndërsa gjithashtu edhe identifikimi dhe ndihma e grave të papunësuara për një afat më të gjatë, dy kategori të prekshme të cilat u përcaktuan në pjesën e studimit të përgatitur për komunën e Pehçevës. Gjithashtu me projektin u absorbua mungesa e mbrojtjes institucionale për personat e sëmurë dhe të moshuar, me çfarë ndihma administrohet në një mjedis natyral, në shtëpinë e personave të cilët kanë nevojë. Projekti është i krijuar në atë mënyrë që në detektimin e personave të moshuar të cilët kanë nevojë për kujdes në kushte shtëpiake është përfshirë Qendra për punë sociale nga Berova, zyra lokale në Pehçevë. Qendra për punësim e komunës së Berovës ndihmoi në identifikimin e grave të papunësuara⁸. Gratë e papunësuara shfaqën interes të madh për t'u

8 Bartës kryesor i projektit është Organizata e grave nga Pehçeva.

përfshirë në projekt dhe në takimin e parë u paraqitën 45 gra, gjë e cila shkaktoi vështirësi gjatë selektimit të personave të cilët do të marrin pjesë në zbatimin e projektit. Pehçeva është një komunë e vogël me 6000 banorë, një mikro-rajon ku të gjithë njihen, kështu që ishte e vështirë të veçohen përfituesit potencial të ndihmës dhe gratë, bartëse të aktiviteteve. Mirëpo, projekti zgjoi një interes, një shkallë më të lartë të aktivizmit tek gratë, një levizshmëri, zbatimin e një ideje të bukur, ndërsa qëllimi përfundimtar gjithashtu është që ky lloj i veprimeve shërbyese të rritet si një aktivitet programik që organizatat joqeveritare të transformohen në qendra për shërbime, për të cilën është e nevojshme që të sigurohen mënyra për financimin e rregullt, si nga komuna ashtu edhe nga institucionet tjera të cilat duhet të hyjnë në këtë proces. Projekti me të vërtetë kontriboi për një kualitet të ri në jetesën e personave të moshuar. Duke e pasur parasyshë numrin e tyre, nuk mund të flitet për institucionalizimin e tyre për shkak se kapacitet të tillë nuk kanë as edhe shtetet më të pasura. Si shfrytëzues të shërbimeve u përcaktuan persona, shfrytëzues të kujdesit të huaj. Me ndihmën e mjekëve amë u fituan informata për personat të cilët nuk kanë këtë lloj të kujdesit, ndërsa kanë nevojë për ndihmë.

Projekti përparon, është bërë shqyrtim i nevojave për atë se çfarë mund të ofrohet siqë janë karrocet invalidore dhe toalet karrocet. Personave të moshuar u ndryshohet kualiteti i jetesës vetëm me disa orë vizitë aq sa qëndrojnë gratë në shtëpitë e tyre (Simovska, Organizata e grave Pehçevë “OGP”).

Në komunën e Negotinës në mënyrë të drejtëpërdrejtë përkrahet pjesëmarrja participative e grupeve të prekshme në procesin e zbatimit të aktiviteteve në suazat e mikro-projektit për “Përfshirje sociale të personave me nevoja të posaçme në bashkësi.” Projekti ka për qëllim që socialisht t’i përfshijë personat me pengesa në zhvillimin intelektual përmes angazhimit të tyre aktiv dhe të vazhdueshëm me punë. Në projekt janë përfshirë 10 persona me pengesa në zhvillimin mental, të cilët përmes trajnimit janë aftësuar dhe angazhuar për të grumbulluar letër dhe plastikë në kontenjera paraprakisht të vendosura në qytetin e Negotinës. Me qëllim që të sensibilizohet opinioni për shfrytëzimin e kontenjerëve të vendosur, si dhe me qëllim që i njehti në mënyrë aktive të përfshihet në aktivitetet e projektit është bërë fushatë mediale dhe është përgatitur material promovues. Projekti e promovon konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal përmes përfshirjes së personave

me pengesa në zhvillimin mental në bashkësinë lokale, angazhimin e tyre me punë në drejtim të gjenerimit të të ardhurave të caktuara, si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor në nivel lokal. Gjithashtu, projekti e promovon konceptin e partneritetit në mes organizatës qytetare, pushtetit lokal dhe subjekt/e nga biznes sektori në drejtim të zgjidhjes së çështjeve të rëndësishme sociale në nivel lokal dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal.

Hapa të ardhshëm në procesin e decentralizimit të mbrojtjes sociale

Në nivel kombëtar, Ministria për punë dhe politikë sociale në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me agjencitë e tjera ndërkombëtare financiare dhe zhvillimore punon në avancimin e procesit të decentralizimit. Aktivitetet të cilat i ndërmerr Ministria për punë dhe politikë sociale janë të numërta. Ato janë projekte të cilat zbatohen ose në ardhmëri të shpejtë do të zbatohen nga ana e Ministrisë, aktivitete të cilat me siguri do të ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave me të cilat do të ballafaqohemi në ardhmëri në procesin e decentralizimit.

Nga aspekti i decentralizimit zbatohet edhe Programi për zhvillimi të mbrojtjes sociale 2011-2021, i cili është një dokument i rëndësishëm, i fokusuar në avancimin e sistemit të mbrojtjes sociale, si dhe të gjitha politikave tjera të cilat Ministria në mënyrë të drejtëpërdrejtë i zbaton, siqë është procesi i deinstitutionalizimit, përfshirjes sociale, uljes së varfërisë etj. Në kornizat e programit, trupi koordinativ në vitin 2011 përgatiti raport për aktivitetet e zbatuara dhe të njejtin i'a dorëzoi qeverisë. Ministria në bashkëpunim me UNDP-në në vitin 2012 bën analizë të hollësishme të kapaciteteve në nivel lokal për ndërmarrjen e shërbimeve sociale. Edhe pse aktivitete të tilla u zbatuan edhe në suazat e projektit të Institutit për të drejtat njerëzore - Llundvig Bolltman, edhe në suazat e projekteve tjera, duhet të theksohet se nuk është bërë një analizë e hollësishme. Të gjitha projektet e deritanishme e trajtojnë këtë çështje nga aspekti i tyre, nga aspekti i analizimit të kapaciteteve, nga aspekti i prekshmërisë, por edhe nga aspekti i bashkëpunimit ndërkomunal. Mirëpo, analiza e hollësishme bazohet në disa komponenta të rëndësishme të cilat do t'i vlerësojnë kapacitetet e të gjithë aktorëve lokal, të qendrave për punë sociale,

të komunave, të sektorit joqeveritar, të shkollave, të sektorit shëndetësor, të biznesit privat etj. Do t'u ndihmojë komunave që vetë t'i përcaktojnë grupet e prekshme në nivel lokal përmes punës me fokus grupe dhe do të kontribuojë në modele të caktuara të cilat do të jenë të përgatitura në formë të doracakut. Gjegjësisht, do t'i japë mundësi vetë komunës përmes një doracaku të definojë modele për zhvillimin e shërbimeve sociale, ndërsa si rezultat përfundimtar do të organizohet një edukim adekuat. Ky është një pilot projekt dhe është shumë e rëndësishme që i njejtë të formulohet në mënyrë adekuate, ashtu si duhet që të mund më tej i njejtë të zbatohet edhe në komuna tjera.

Programi kombëtar për zhvillim fokusohet në zbatimin e të gjitha aktiviteteve dhe parasheh model të ndarjes së kompenzimeve në para nga qendra për punë sociale dhe menaxhimin e tyre nga ana e një agjencie të posaçme, me çfarë ato do të ndërlidhen me sistemin e punësimit dhe do të ofrohen modele më aktive të punës me vetë shfrytëzuesit në aspekt të përfshirjes së tyre më të madhe në tregun e punës dhe ndarje të shërbimeve sociale ose siqë thuhet servise në qendrat për punë sociale, dhe ndërlidhshmëri më e madhe të tyre me vetë komunat dhe me të gjithë aktorët në nivel lokal. Vetë strategjia për zbatimin e këtij procesi parasheh formimin e Këshillit për parandalim, në të cilin do të marrin pjesë të gjithë aktorët relevant në nivel lokal. Si i dytë do të jetë Këshilli për shërbime sociale i cili do të merret me zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale, dhe këshilli i tretë do të jetë Këshilli për punësim. Këto këshille varen nga suksesi me të cilin do të menaxhohet ky proces i ndarjes së kompenzimeve në para nga shërbimet sociale.

Ministria për momentin punon në dy projekte të fituara përmes IPA programit, komponentës katër. Projekti i parë ka të bëjë me përf forcimin e kapaciteteve të komunave dhe sektorit joqeveritar, që të mund të njejtat të fitojnë shkathtësi për përgatitjen e projekteve adekuate dhe në mënyrë të pavarur të aplikojnë me projekte për IPA fondet. Projekti i dytë është i orientuar kah përfshirja e grupeve të prekshme në tregun e punës dhe ka të bëjë me ndihmën teknike në aspekt të edukimit të të gjithë aktorëve në nivel lokal të cilët mund të përfshihen në këtë proces, duke i përfshirë qendrat për punë sociale, sektorin joqeveritar, administratën komunale etj. Me zbatimin e këtyre projekteve pritet që të hapet dera e procesit të mëtutjeshëm të përgatitjes së projekteve më konkrete, në të cilat ministria nuk do

të jetë bartësi kryesor por pritet angazhim më i madh nga vetë komunat dhe nga sektori joqeveritar, gjegjësisht pritet rrjetëzimi i tyre në nivel lokal.

Sa u takon kapaciteteve të qendrave për punë sociale rrjedhin disa procese, gjegjësisht aktuale është zgjidhja e shtëpisë këshilluese e cila do të bëjë një analizë funksionale të të punësuarve në qendrat për punë sociale, me qëllim që të ofrohet një model i ri i organizimit të tyre dhe të njejtit të vendosen në funksion të nevojave të dhënies së shërbimeve sociale, por edhe nga aspekti i zbatimit të të gjitha politikave strategjike të ministrisë. Gjithashtu, realizohet edhe procesi i licencimit i cili duhet të inicojë një vazhdimësi në aspekt të edukimit të planifikuar të personave profesional.

Ministria për punë dhe politikë sociale në mënyrë normative e rregulloi bashkëpunimin me sektorin joqeveritar. Përfaqësuesit e sektorit joqeveritar në mënyrë aktive marrin pjesë në trupat koordinativ, participojnë në krijimin dhe zbatimin e politikave, megjithatë ky proces me siguri se duhet të plotësohet dhe bashkëpunimi të avancohet.

Shembull konkret është ajo që UNDP për herë të parë organizoi projekt për bashkëpunim ndërkomunal për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe u përgatitën plane vepruese. Gjë e cila do të thotë se u braktis koncepti për mjedisin jetësor dhe në agjend erdhën edhe shërbimet sociale, dhe mund të thuhet se planet pas zbatimit të projektit ishin shumë kualitative në aspekt të angazhimit të komunës në ndërmarrjen e masave konkrete dhe të realizueshme në nivel lokal. Jemi të mendimit se në këtë mënyrë duhet ta ndërtojmë procesin e decentralizimit të përfshirjes sociale në komunat.

Shërbimet sociale, si forma të reja më janë themeluar në vend. Nga ana e Ministrisë ato krijohen në bazë të hulumtimeve për nevojat e qytetarëve. Në këtë mënyrë është krijuar sistemi i jetesës së pavarur për përkrahjen e personave me invaliditet. Janë krijuar të drejta të reja siqë është e drejta e mobilitetit të qytetarëve me pengesa në të pamurit, është rritur shumica e ndihmës, është miratuar ligj për gjuhën e shenjave, përfshirja e personave të shurdhër në të gjitha proceset shoqërore, shtëpitë e vogla grupore etj. E rëndësishme është të theksohet se Ministria ka ndijesi për nevojat e qytetarëve, mirëpo e njejtja varet shumë nga mundësitë e saj. (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS).

Znj. Todorovska, udhëheqëse e Sektorit për përfshirje sociale në MPPS e theksoi rëndësinë e zbatimit të programit për punë patronike sociale, i cili jep rezultate të mëdha në nivel lokal në tre pilot komuna në Shkup, dhe atë në komunën Qendër, Gazi Babë dhe Gjorçe Petrov. Në program u ofrohet ndihmë e drejtëpërdrejtë kategorive të prekshme në rrugë. Punonjësit social dalin nga stereotipi i punës byrokratike dhe në suazat e këtij programi ato u ndihmojnë kategorive të prekshme që të futen në sistemin e mbrojtjes sociale. Në këtë mënyrë programi mundëson që të arrihet parandalimi përmes qasjes multidimensionale e cila krijohet përmes bashkëpunimit vertikal dhe horizontal.

UNDP së bashku me Ministrinë punon edhe në krijimin e masave aktive për punësim përmes punës së dobishme komunale. Ky është një pilot program i cili do të zbatohet këtë vit. Në suazat e këtij programi do të bëhet një numër i vogël i punësimeve dhe do të mundësojë që të punësohen një numër i vogël i personave të cilët do t'u sigurojnë shërbime kategorive të prekshme. Nëse ky dëshmohet për të qenë i suksesshëm do të krijojë mundësi për financim më të madh të programeve të ngjajshme (Ramadani, përfaqësues i UNDP-së).

Konkludime dhe rekomandime

Pas diskutimit të detajuar, të bërë gjatë tryezës së rrumbullakët në temë “Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë - Gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal”, si dhe hulumtimet për vlerësimin e gjendjeve lokale, u formuluan rekomandime adekuate dhe u mundësuan konkludime konkrete.

Bashkëpunimi multisektoral u imponua si temë qendrore në procesin e decentralizimit të mbrojtjes sociale. Llogaritet se është e domosdoshme që të bëhet rrjetëzimi dhe inkurajimi i të gjithë aktorëve në nivel lokal. Në pajtim me eksperiencat e deritanishme, shërbimet sociale dhe decentralizimi i tyre varen nga mënyra e vendosshmërisë së sistemit. (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS). Decentralizimi nuk mund të arrihet pa përfshirjen e të gjithë faktorëve, si ato në nivel të njësive të vetëqeverisje lokale, ashtu edhe në nivel kombëtar. Ka kapacitete të pashfrytëzuesara jo vetëm në sektorin joqeveritar, por edhe tek individë të cilët janë në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes lokale. Ad-

ministrata komunale ato i sheh si konkurrencë e cila i rrezikon pozitat e tyre, mirëpo ato duhet të shihen si njerëz me eksperiencë për ndonjë çështje nga sfera e mbrojtjes sociale (Trajkovska, kryetare e Shoqatës qytetare “Poraka” Negotinë).

Vlerësohet se gjendjet lidhur me kapacitetet e komunave janë të ndryshme dhe nga ato varet edhe vetë procesi i decentralizimit të mbrojtjes sociale. Realisht ekzistojnë komuna të ndryshme me fuqi të ndryshme. Në komunat nuk ka infrastrukturë adekuate, as po mjete të dezintegruara për këtë qëllim. Për këtë shkak është e nevojshme që të gjindet një mekanizëm në kornizat e buxheteve për përcaktim të detyrueshëm të mjeteve për mbrojtje sociale (Jankullo, Komuna e Konçes). Ajo nuk duhet të jetë vetëm e llojit të ndihmave materiale, por edhe në aspekte të tjera nga sfera e përfshirjes sociale. Mirëpo, mjediset më të vogla shumë vështirë do të gjinden në përmbushjen e nevojave nga sfera sociale, jo vetëm nga aspekti material por edhe nga aspekti kadrovik për shkak se personat profesional, kuadrot e reja, i braktisin këto mjedise. Prandaj do të duhet të punohet edhe më tej në inkurajimin më të madh të njerëzve që të mund të orientohen kah bashkëpunimi më i madh për përmbushjen e nevojave të qytetarëve (përfaqësues nga komuna e Pehçevës).

U theksua se decentralizimi nuk varet aq shumë nga implikimet financiare sa që varet nga vetë aktorët. Këtu mendojmë për përfaqësuesit e organizatave qytetare dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal. Nga vetë sektori joqeveritar varet se sa ai do të ketë sukses në imponimin e kërkesave të tij, ndërsa nga përfaqësuesit e pushtetit lokal varet se sa të përkushtuar do të jenë në zgjidhjen e kërkesave të tyre ose disa nga nevojat e tyre. Problem i posaçëm paraqitet kur komuna shpall thirrje për përkrahje të shoqatave qytetare. Organizata joqeveritare janë edhe shoqatat sportive, shoqatat e bletarëve, shoqatat e ekologjistëve dhe shoqatat e personave me nevoja të posaçme, të personave të moshuar. Gjëja e parë e cila duhet të bëhet është distinkcioni mes organizatave të llojit të bletarëve dhe ekologjistëve, dhe organizatave të cilat punojnë në sferën e mbrojtjes sociale ose të drejtave njerëzore, të cilat duhet të perceptohen në mënyrë të ndryshme, në veçanti nëse ato organizata paraqiten si sigures të shërbimeve sociale servitore konkrete (Krstevski, zyra kombëtare e QRPPPI Poraka). Gjithashtu, theksohet nevoja për qëndrueshmërinë e shërbimeve të decentralizuara sociale. Duhet seriozisht të mendohet gjatë mirati-

mit të buxheteve të komunave dhe është e nevojshme që procesi të jetë transparent. Ekziston nevoja për diskutime publike për alinetë të cilat nga buxheti ndahen për sektorin qytetarë. Komisionit që punon në vetë buxhetin duhet t'i dorëzohen parashtesa dhe kjo duhet të jetë praktikë në të gjitha komunat. Është e nevojshme që një numër më i madh i qytetarëve të përfshihen në krijimin e buxhetit për shkak se mjetet vijnë nga qytetarët dhe buxheti duhet të jetë për ta. Apeloher për një zgjueshmëri më të madhe të sektorit joqeveritar ateherë kur miratohen buxhetet që edhe ato të marrin një pjesë të kulaçit për realizimin e aktiviteteve të tyre programike. Mirëpo apeloher edhe për vetëdëshmëri më të madhe të pushtetit lokal, deri tek kryetarët e komunave, deri tek këshilltarët të cilët do ta votojnë buxhetin, që ato të përkrahin diçka e cila është prioritare dhe e nevojshme për komunën (Zlataeva, kryetare e Shoqatës për përkrahje të personave me paralizë celebrale, Qendra ditore për persona me invaliditet, Çashka).

Besohet se sukcesi i procesit të decentralizimit të mbrojtjes sociale varet nga ajo se a zhvillohen shërbimet në pajtim me nevojat e qytetarëve. "Mbrojtja sociale në nivel lokal, gjegjësisht nevojat e qytetarëve jo gjithmonë kushtojnë shumë për shkak se ajo nuk është institucion por përkrahje dhe ndihmë për qytetarët dhe varet nga ajo se si ato jetojnë dhe për çka kanë nevojë. Prandaj edhe i theksuam dhe i veçuam planet vepruese. Komuna duhet të dijë se cilat i ka grupe në rrezik, se a ka në vendbanimet ose vendet më të larguara persona të moshuar për të cilët askush nuk kujdeset, a ka persona me invaliditet të cilët askush nuk i ka përfshirë në ndonjë proces, a ka fëmijë pa prindër të cilëve në çfarë do mënyrë duhet t'u ndihmohet. Jo gjithmonë janë të nevojshme shërbimet të llojit të ndonjë institucioni siqë është shtëpia për persona të moshuar, çerdhja fëminore etj. Kjo nuk është proces. Shteti më nuk e bën këtë, komunat duhet ta bëjnë. Është i nevojshëm participim aktiv dhe bashkëpunim, dhe të gjithë këtë ta bëjmë në interes dhe për të mirën e qytetarëve (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS)."

Një nga rekomandimet kryesore lidhur me procesin e decentralizimit është i orientuar kah participimi aktiv i qytetarëve në zbatimin e aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes sociale, si dhe vlerësimi dhe investimi në ndërtimet e kapitalit njerëzore dhe shfrytëzimin e fuqive sociale. Në këtë kontekst, profesoresha Maria Donevska nga Instituti për punë sociale dhe politikë sociale e thekson domethënien e

maksimës së Platonit “të dishë nuk do të thotë edhe të mundesh”. Kështu që ajo thekson se “në nivel lokal mund të kemi njëqind strategji, t’i shkruajmë, t’i përgatisim, mirëpo nëse nuk e dimë pulsën e popullatës me të cilën punojmë, nëse nuk dimë në cilën mënyrë dhe me cilat shkathtësi duhe t’i mobilizojmë që ato të fillojnë të bashkëpunojnë me ne, nëse nuk i dimë sekretet e disa teknikave të caktuara të bashkëpunimit me popullatën, nëse nuk dimë se rezultatet arrihen vetëm përmes përfshirjes së njerëzve të cilët jetojnë në bashkësinë lokale, nuk do të arrijmë asgjë.” Prandaj edhe ajo llogarit se “në trajnimin e njerëzve të cilët janë të quajtur fuqi sociale, në të cilën bëjnë pjesë organizatat joqeveritare, duhet të vendoset theks i veçantë mbi shkathtësitë për të punuar me popullatën lokale. Duhet paraprakisht të dihet se popullata lokale pjesërisht din për proceset të cilat duam t’i ndryshojmë në zhvillimin lokal të bashkësisë. Duhet të dimë se njerëzit në bashkësinë lokale në të cilën jetojmë kanë prioritetet e tyre të caktuara për aktivitetet sociale në bashkësinë lokale. Duhet t’i marrim parasysh edhe fuqitë sociale dhe ato jo gjithmonë janë kështilltarë, aktivistë të institucioneve të caktuara, por mund të jetë edhe ndonjë person më i moshuar i cili ka autoritet të madh në bashkësi. E gjithë kjo është e nevojshme kur punojmë në bashkësinë lokale. Rekomandojmë që më tepër të punojmë në zhvillimin e shkathtësive për atë se si punohet për shkak se pa këto nuk do të arrijmë asgjë edhe pse disa punë duken shumë mirë në letër, mirëpo në praktikë kjo ka të bëjë me sekretin në zanatin dhe profesionin tonë.”

Sa i takon pjesëmarrjes së biznes sektorit mund të them se është pika e dobët në këtë proces për shkak se fitohet besimi se tek ato mungon ndjenja e përgjegjësisë shoqërore. Ndoshta ende janë në periudhën e tranzicionit që të mendojnë për diçka më tepër veç profiteve të tyre, të ndajnë diçka edhe për qytetarët. Mirëpo që kjo të ndryshohet, sektori joqeveritar duhet shumë më tepër të punojë në animimin e tyre, që t’u ndihmohet të mendojnë në mënyrë të përgjegjshme shoqërore, gjegjësisht se edhe ato munden të kontribuojnë. Nëse mendohet për disa grupe, biznes sektori nuk është edhe aq i keq, mirëpo kemi nevojë për qasje, komunikim me ta për t’u realizuar njëfëar ndihme e përhershme në para brenda buxhetit në nivel të komunës dhe kjo është e mundur, mirëpo ato duhet të sensibilizohen për këtë. Jam e mendimit se duhet më tepër të punojmë në këtë aspekt (Simovska, Organizata e grave Pehçevë “OGP”).

Në fund do të theksojmë se mbrojtja sociale jo gjithmonë implikon shpenzime të larta. Shpesh i harrojmë kapacitetet bazike të cilat i kemi në disponim në vetë komunat, të cilat janë të vendosura dhe nuk shfrytëzohen në funksion të mbrojtjes ose sigurimit të nevojave bazike të qytetarëve. Ndonjëherë është e mjaftueshme që të animohet një grup i vullnetarve i cili do të ndihmojë në sigurimin e asaj që është nevojë ekzistenciale e nje grupi të caktuar të prekshëm.

Listë e personave prezent në tryezën e rrumbullakët – Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë të organizuar më datë 30.03.2012

	Emri dhe mbiemri	Organizata/institucioni
1.	Petranka D. Milladinova	Udhëheqës i BIM-FV Shkup
2.	Ibrahim Ibrahimi	Zëvendës ministër për punë dhe politikë sociale (MPPS)
3.	Irena Todoroska	Udhëheqës i Sektorit për përfshirje sociale në MPPS
4.	Svetlana Trbojeviq	Moderator, Instituti për punë sociale dhe politikë sociale
5.	Milla Carovska	Kryetar, Platforma maqedonase për luftë kundër varfërisë PMKV
6.	Sofija Spasovska	Zëvendës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS
7.	Milica Konevska	Njësia për përfshirje sociale në MPPS
8.	Katerina Savovska	IP QNPS Shkup
9.	Robert Sharllamanov	Agjencia austriake për zhvillim
10.	Meri Terzieva	MPPS
11.	Ivana Stojanovska	MPPS
12.	Stojan Llazarev	Kryetar i komunës së Konçes
13.	Zllatko Jankullo	NJVL Konçe
14.	Hava Abduramanova	NJVL Konçe
15.	Slobodanka Krteva	NJVL Negotinë
16.	Sllavko Kolev	IPN Qendra për punë sociale Negotinë
17.	Ljupço Karakashovski	NJVL Pehçevë
18.	Lidija Pljakova	NJVL Çashka
19.	Sali Latifov	NJVL Çashka
20.	Olivera Dolldurova	NJVL Radovish
21.	Violeta Temellkova	NJVL Radovish
22.	Zorica Stefanova	Organizata e grave e komunës së Konçes

23.	Gordana Trajkovska	Poraka, Negotinë
24.	Valentina Taseva	Poraka, Negotinë
25.	Nada Simovska	Organizata e grave të komunës së Pehçevës
26.	Daliborka Zlateva	Shoqata e qytetarëve me paralizë cerebrale – SHPPC Veles
27.	Vllado Krstovski	Qendra republike për persona me pengesa intelektuale – QRPPi PO-RAKA
28.	Ibadetka Cupeska	Shoqata SASTIPE ZDRAVJE Berovë
29.	Elena Neshovska	Shoqata Sumnall
30.	Marija Gelevska	Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave të R.M. ESE
31.	Teodora Dillberova	Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave të R.M. ESE
32.	Jana Popovska	Shoqata Humanost
33.	Divna Zmejkoviq	Unioni i sindikatave të pavarura autonome të Maqedonisë - USAM
34.	Maria Doneska	Fakulteti filozofik
35.	Filip Babamov	SOS Detsko Sello
36.	Nehat Ramadani	UNDP
37.	Nafi Saraçini	Delegacioni i BE-së
38.	Biljana Tanevska	Radioja maqedonase
39.	Natasha Jançiq	MTV
40.	Ninosllav Mlladenoviq	BIM-FV Shkup
41.	Jagoda Iljov	BIM-FV Shkup
42.	Stojan Mishev	BIM-FV Shkup

Literatura e shfrytëzuar

Donevska M, et al. (2011), Studim për varfëri dhe ç'kyçje sociale në Republikën e Maqedonisë: Probleme dhe nevoja sociale lokale: Shkup: Instituti për të drejtat njerëzore "Lludvig Bolltman"

Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave të RM – ESE (2010) "Analizë e gjendjeve aktuale në mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale, Shkup: Instituti për të drejtat njerëzore "Lludvig Bolltman"

Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e RM nr. 5/2002

Ligji për organizim territorial të njërive të vetëqeverisjes lokale, Gazeta zyrtare e RM nr. 55/2004

Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale, Gazeta zyrtare e RM nr. 61/2004

Ligji për mbrojtje sociale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 50/97, 16/2000, 17/2003, 65/2004).

Ligji për mbrojtje sociale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 79/09“).

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Çashkës 2011-2015

Strategji për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Studeniçanit 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Negotinës 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Likovës 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Berovës 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Pehçevës 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Radovishit 2011 – 2015

Strategjia për mbrojtje sociale, përfshirje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Konçes 2011 – 2015

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

342.25(497.7)

DECENTRALIZIMI i mbrojtjes sociale ne Republiken e Maqedonise :
gjendja faktike, sfidat dhe mundesite ne nivel lokal. - Shkup :
Instituti per te drejtat njerezore Llundvig Bolltman, 2012. - 37
стр. ; 21 см

Превод на делото: Децентрализација на социјалната заштита во
Република Македонија. - Публикацијата е во рамките на проектот: “Те
drejtat njerezore dhe perfshirja sociale ne Maqedoni”. - Фусноти кон
текстот. - Библиографија: стр. 37

ISBN 978-608-65321-5-4

а) Децентрализација - Македонија

COBISS.MK-ID 91652106

ISBN





ISBN



9 786086 532154